



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Infermieri e Përgjithshme”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Ismail Qemali”, Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Vjollca Durro

2. Prof. As. Etleva Refatllari

Prill/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme ofruar nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Infermieri e Përgjithshme
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 105, datë 28.02.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASH Nr. 398, datë 10.08.2011
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	--
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	48/1
18	Numri i studentëve:	574 studentë
	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” zhvillohet në Departamentin e Infermierisë të Fakultetit të Shëndetit në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë(UV), është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me VKM Nr nr. 105, datë 28.02.1994 dhe akredituar me Vendim ASCAL Nr. 71, datë 21.09.2017. Ai përbëhet nga katër fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, teknike, human dhe mjekësore. Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme”(IP) zhvillohet në Departamentin e Infermierisë(DI) në Fakultetin e Shëndetit. Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” është hapur për herë të parë me VKM Nr 105 datë 25.02.1994, është bërë pjesë Fakultetit të Shëndetit dhe riformatuar me UMASH nr.398 datë 10.08.2011. Në vitin 2016 me vendin të Senatit Akademik nr.59 datë 31.10.2016 “Për organizimin e pjesshëm të planit mësimorë në programet e studimit bachelor në infermieri të përgjithshme dhe “ Infermier Mami” është bërë ndryshim në lëndën “Principet bazë në infermieri” ku nga lëndë simestrale me 45 leksione dhe 30 praktika laboratorike bëhet lëndë vjetore me 60 leksionë dhe 75 orë praktika laboratorike në total 11 ETC. Këto ndryshime ndikojnë në shtimin e informacionit teorik në edukimin bazë për formimin e infermierit të përgjithshëm si dhe formimin e tij praktik në realizimin e manipulimeve apo kryerjete procedurave infermierore në mënyrë të pavarur. Ndërsa lënda “Terminologjia mjekësore” nga lëndë me 7 ETC bëhet me 4 ETC. Këto ndryshime nuk ndikojnë në përgatitjen teorike të studentëve në këtë lëndë. Program Bsc në IP është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloren e institucionin, ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit në Universitetin e Vlorës, filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti i Vlorës, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, është realizuar procesi i vlerësimit sipas axhendës së miratuar nga IAL dhe ASCAL.

Në përputhje me axhendën e dërguar nga ASCAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi takimet në institucion në datat 3 dhe 4 dhjetor 2020. Grupi është i përbërë nga 2 ekspertë të jashtëm dhe specialistja e ASCAL znj. Juna Mengri.

Takimet u zhvilluan OnLine me Drejtues të Fakultetit të Shëndetit, të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor dhe Departamentit të Infermierisë, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentë të programit të studimit, me stafin akademik të programit të studimit, me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me sekretarinë, me zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë. U realizuan vizita virtuale me pyetje, shpjegim dhe komunikim në auditorë, laboratorë, ambientet e bibliotekës dhe sekretarisë.

Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuar institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm.

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.03.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/24 Prot, datë 29.03.2021. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë përcjell në ASCAL më datë 06. 04 2021, nëpërmjet sistemit AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 548/1 Prot, datë 12.04.2021 “Përcjellje e komenteve mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” dhe Bachelor në “Infermieri Mami””, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Bsc Infermieri e Përgjithshme”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PRORAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV), është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me VKM Nr. 105, datë 28.02.1994 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 71, datë 21.09.2017. Në përberje të tij janë katër fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, teknike, humane dhe mjekësore. Programet që ofron institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit vëndit në përputhje me profilin e institucionit (Statusi UV).			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programete studimit të ofruara nga institucioni kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin UV si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shëndetit.(Statusi i UV dhe Regullorja e funksionimit të FSHP)			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi Bachelor Infermieri e Përgjithshme zhvillohet në Departamentin e Infermierisë pranë Fakultetit të Shëndetit. Referuar dokumentacionit mbështetës të RVB, GVJ konstaton se programi Bsc në Infermieri e Përgjithshme(IP) është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UV dhe Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016-2020(Statusi UV)			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi bachelor Infermieri e Përgjithshme ka një ndërthurje të dijeve teorike me ato praktike të cilat i mundësojnë studenteve aftësimin e tyre profesional në ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe për të qënë konkurent në tregun e punës. Bazuar ne RVB, rezulton se ky program studimi është i bazuar në eksperiencën e tij disa vjeçare si dhe nevojat në rritje të tregut të punës për infermier jo vetëm në nivel lokal po dhe kombëtar duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vëndit. (evidenc 1.1 Programi mësimor në IP)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓



Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi Bsc në “Infermieri përgjithshëm” është një nga programet më të vjetra në kohë të ofruara nga UV që daton me krijimin e institucionit. Ky program është hartuar në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe i ka shërbyer edukimit dhe përgatitjes së infermierëve profesionistë për plotësimin të nevojave të tregut të punës jo vetëm në nivel lokal por dhe kombëtar (statusi UV, rregullorja eFSHP).			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritarë akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion GJV konstaton se statusi UV dhe rregullorja e FSHP përcaktojnë qartë objektivat dhe drejtimit kryesore të zhvillimit akademik të institucionit. Programet e studimit të ofruar nga FSHP janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UV dhe me profilin e institucionit(statusi UV, rregullorja e FSHP, rregullorja e programit Bsc. “Infermieri e Përgjithshme).			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Program Bsc në Infermieri e Përgjithshme është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin e UV dhe rregulloren e institucionit , Ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të	Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse misionin dhe objektivat e tij [rregullorja e programit Bsc. “Infermieri e përgjithshme].Bazuar në këto objektiva, programi synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës dhe përgatitjen e infermierëve të përgjithshëm për ofrimin e shërbimit shëndetësor për çdo patologji dhe grup moshë nëpërmjet aftësimin profesional

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	të tyre, zhvillimit të aftësive të komunikimit midis stafit mjekësor, pacientëve dhe familjarëve të tyre.
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, takimin me drejtuesit e FSHP dhe departamentit GVJ konston se institucioni mban kontakte të vazhdueshme me institucionet shëndetësore publike, Urdhërin e Infermierit të qarkut Vlorë, lidhur me nevojat e tregut të punës për infermier duke mbledhur të dhëna për vëndet e lira të punës, numrin e presonelit që del në pension, numrin e studentëve të FSHP të punësuar pas diplomimit. Për studimin e tregut të punës institucion shfrytëzon dhe të dhënat nga portal i punësimit të infermierëve, ëëbsite të agjensive të punësimit, të institucioneve shëndetësore publike kombëtare dhe ndërkombëtare [takimi me stafin drejtues, komunikimi shkresor me institucionet].</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitimn e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e për këtë arsye objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, që matin rezultatet e pritshme të të nxënit, që garantojnë përfitimn e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut e që mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve, janë pasqyruar qartë.</p> <p>Një element i rëndësishëm në formimin profesional të studentëve janë laboratorët (të cilët janë të paisur me paisjet e domosdoshme si mulazhe, manikina simulatorë) për realizimin e praktikave mësimore të cilat ju shërbejnë studentëve për fitimin e shprehive të punës duke ju krijuar një ambient të ngjashëm me ambientet shëndetësore spitalore. (programi i studimit, vizita online në ambientet e FSHP). Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale. Në programet e studentëve në viti e II dhe të III vihet re një ndarje të oreve terike dhe praktikë 50% me 50% si dhe ndarja e ndarja e studentëve në grupe sips numrit të rekomanduar për realizimin e praktikës profesionale.Pasja e një numri të vogël studentësh, jep mundësi për praktikimin e njohurive në qendrat shëndetësore rajonale dhe fitimin e aftësive për tu përballur dhe zgjidhur problemet e ndryshme që</p>




	kërkojnë zgjidhje infermierore. GVJ e konsideron realizimin e praktikave profesionale si praktikë të mirë dhe një nga pikat e forta të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Institucioni ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë në Infermieri të Përgjithshme (licensuar me VKM Nr. 105, datë 25.02.1994 dhe riorganizuar me UMASH nr.398 datë 10.08.2011 me hapjen e FSHP me tre departamente njëri prej të cilëve është departamenti i Infermierise së Përgjithshme), çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime

	<p>njerëzore në staf akademike dhe mbështetës. [vizita e ambienteve; Evidenca 3.29 Lista e paisjeve lab; Evidenca 3.28 Lista e paisjeve audivizive, programi i studimit Bsc].</p> <p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit [takimi me stafin drejtues, stafin akademik dhe mbështetës, vizita në ambientet e UV].</p> <p>GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore si laboratorët e anatomisë humane, infermierisë, mamisë dhe qendra simulatore për trajtimin shëndetësor, të cilat ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët.</p> <p>GVJ evidentoi se institucioni ka kapaciteteve akademike të mjaftueshme për realizimin e programeve të studimit ku shumica e lëndëve/moduleve mbulohen kryesisht nga stafi akademik efektiv [lista e stafit, programi studimit]</p> <p>FSHP ka 34 staf akademik efektiv në fushën e mjekësisë dhe infermierisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Për realizimin praktikës profesionale të studentëve FSHP dhe UV kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike të qarkut të Vlorës si spitali rajonal Vlorës , spitali Fierit, Lushnjës, spitali psiqiatrik Vlorë, Opertori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (RVB fq 11, marrëveshjet e bashkëpunimit)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Shëndetit përbëhet nga tre departamente Departamenti Infermierisë, Departamenti i Kujdesit Shëndetësor dhe Qendra kërkimore shkencore e shëndetit publik. FSHP në total ofron 6 programe të ciklit të parë dhe të dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Bachelor në “Infermieri përgjithshme”; – Bachelor në “Infermieri mami” – Master profesional në “Infermieri patologjike”; – Master profesional në “Infermieri kirurgjikale”; – Master profesional në “Infermieri pediatrike” – MS në shkenca infermierore . <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore [evidenca1.2 Regullorja e FSHP].</p>




	Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Bsc në Infermieri të Përgjithshme ofrohet nga Departamenti infermierisë fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Departamenti i Infermierisë ku zhvillohet ky program studimi ka 12(dymbëdhjetë) staf akademik efektiv, 3(tre) staf akademik me kontratë që kanë tituj dhe grada shkencore. Departamenti ka dhe 29(dy) staf akademik mbështetës/laborant në funksion të programeve të studimit që ofron[tabela 2] Niveli i njohurive që ofron programi përkon me atë të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve / EQF [evidenca 1.1 programi studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Fakulteti i Shëndetit është pjesë e UV. FSHP ofron 6 programe studimi ku përfshihet dhe programi i studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme. Në këtë program studimi në të tre vitet akademike janë mbi 500 studentë. (regulorja e FSHP). Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Sikundër u theksua gjatë takimit me drejtues të fakultetit dhe departamentit në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi ngushtë që egziston midis departamenteve të FSHP, departamentëve të lëndëve jo mjekësore dhe stafit akademik respektiv. Bashkëpunimi dhe detyrat brënda njësisë bazë apo programeve bazohen në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>regulloren e funksionimit të FSHP dhe departamentit të infermierisë ku realizohet programi i studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme dhe analizohen çdo vit akademik në raportin vjetor të analizës së veprimtarisë së departamentit.</p> <p>Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësues, projekteve, hartimin e buxhetit, rekrutim stafi akademik etj funksionojnë ngritja e grupeve “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik të departamentit të infermierisë ose të departamenteve të tjera të FSHP. Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHP apo departamenteve të lëndëve jo mjekësore si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi.</p> <p>[takimi me drejtuesit, regullorja e FSHP, raporti analizës vjetore të departamentit]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bsc Infermieri i Përgjithshëm institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe shëndetësore brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me spitalet e Vlorës, Fierit, Operatori i shërbimit të kujdesit shëndetësor Vlorë, Spitali Psikiatrik Vlorë që ndihmojnë studentët të zhvillojnë praktikën profesionale, realizimin e temave të dilomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimin e kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunitorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.</p> <p>UV dhe FSHP kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierit Vlorë për marrjen e të dhënave lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në FSHP apo nevojat e tregut të punës, Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, Kolegjin e sporteve dhe shëndetit të Beogradit, Universitetin Heimmer në Prishtinë, TEI Cretë, Universitetin Tallin në Estoni, Universitetin Leon ne Spanjë, Projekte bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studente në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projekte ndërkombëtare (evidenca të vëna në dispozicion të GVJ në faqen ASCAL) në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Departamenti i Infermierisë, si njësia bazë ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit e programit të studimit Bsc. në Infermieri të Përgjithshme si ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e</p>




bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	aktiviteteve të përbashka me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e projekteve të ndryshme apo mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve[raporti vjetor mbi aktivitetin e departamentit të infermierisë].			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Për realizimin e këtij program studimi FSHP dhe departamenti infermierisë, në fillim të vitit akademik për mbikëqyrjen dhe koordinimin e realizimit të praktikës profesionale, temave të diplomës, studime në fushën e shëndetit emëron koordinatoret e praktikës nga DI dhe institucionit ku realizohet praktika apo aktivitet e tjera. [evidenaca1.1 programi mësimor Bsc IP, marveshjeve e bashkëpunimit me institucionet shëndetësore, komunikimi shkresor për përcaktimin e koordinatorëve apo udhëheqësve të praktikës]			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar në regulloren e FSHP, edukimi në vazhdim dhe shërbimet komunitare është një nga misionet e FSHP. FSHP organizonë ëorkshope, seminare, leksione të hapura, trajnime në bashkëpunim me mjekë të Spitalit të Fierit, Urdhërin e infermierit, Konferanca të kombëtare dhe ndërkombëtare. Një vënd të rëndësishme zë organizmi i konferencës së parë të Studentëve të FSHP mars 2019[dokumentacione lidhur me këto aktivitet gjenden në ëebsite e FSHP].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi Bsc Infermieri e Përgjithshme është hapur për herë të parë me VKM Nr. 105 datë 25.02.1994 dhe është riorganizuar dhe bërë pjesë Fakultetit të Shëndetit me UMASH Nr.398 datë 10.08.2011. Në vitin 2016, me vendim Nr. 59 datë 31.10.2016 të Senatit Akademik është bërë riorganizim i pjesshëm i programi Bsc Infermieri e Përgjithshme. Lënda “Principet bazë të infermierisë” nga modul simestral me 45 leksione dhe 30 praktika laborator bëhet me modul vjetor me 11 ETC (60 orë leksione dhe 75 orë laborator). Lënda terminologjia mjekësore nga 7 ETC(45orë leksione dhe 30 orë seminare) behtë me 4ETC(30 orë leksione dhe 15 orë seminare). Këto ndryshime janë pasqyrur në planin dhe orarin mësimor.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë FSHP sipas nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 180 ECTS, kohëzgjatje 3 vite akademike, të ndarë në dy semestra për çdo vit akademik , në total 6 semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 të MASR datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në total programi ka 4500 orë prej të cilave 54.7% janë jashtë auditorit.</p> <p>Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor në infermieri të përgjithshme"[Rregullorja FSHP dhe rregullorja e programit të studimit, kurikula e programit].</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.	<p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Programi i studimit synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës dhe siguron informacionin bazë për përgatitjen e infermierit të përgjithshëm me formim të plotë dhe të gjithanshëm për ofrimin e kujdesit shëndetësor bazë për çdo patologji dhe grup moshë. [Programi studimit Bsc Infermiereri e Përgjithshme, plani mësimor]</p>
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë	<p>Programi i studimit Bsc në Infermieri të Përgjithshme, përmban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive bazë mbi metodat e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>parimet shkencore të përgjithshme, në fushat specifike dhe të specializuara të infermieristikës si dhe i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe përfitimin e njohurive të tyre profesionale bazë për kualifikime të mëtejshme.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikëve profesionale, ju shërbejnë studentëve për përftimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për ti shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale dhe zgjidhjen e situatave komplekse. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, studentët kanë fituar njohuritë dhe kapacitet e nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë. [takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Infermier i përgjithshëm përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sipas akteve ligjore në fuqi. Programi Bsc IP është i organizuar me kohë të plotë në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me 60 ETC për çdo vit akademik në total 180 ETCS,(2037 orë mësimore në auditor dhe 2463 jashtë auditorit) nga të cilat praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar i shkojnë 14 kredite[Plani mësimor i programit]. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë. Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar nga Këshilli Drejtues i Fakultetit [Dosja e programit Bcs IP 2018—2021 dhe 2019-2022, plani mësimor, rregullorja e FSHP]. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, projekte/detyra kursi, praktikë mësimore/profesionale. Në vitin e dytë dhe të tretë, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve shëndetësore me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. [marrëveshjet e bashkëpunimit]. Praktika profesionale është 10 ECTS /240 orë. Ajo mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizimin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën [Rregullorja e programit Bsc IP]. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Neni 59 pika 8. GVJ shqyrtoi dokumentin lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2017- 2020 të miratuar me vendim të senati. Ngarkesa mësimore përcaktohet në orët mësimore në auditor dhe</p>




	përfshirja në aktivitete të tjera në dobi të fakultetit [Evidena 1.29 Ngarkesa mësimore e pedagogëve]			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Programi i studimit Bsc në Infermier i përgjithshëm përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në :</p> <ul style="list-style-type: none"> i) Lëndë bazë me 27 ETC(16%) ii) Lëndë karakterizuese 97 ETC(55%) iii) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 22 ETC(14.4) iv) Lëndë plotësuese 12 ETC(11%) v) Detyrime përmbysëse 6 ETC(3.3%) 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Ky program studimi realizohet pranë departamentit të infermierisë. Struktura organizative e departamentit/programit përbëhet nga grupi mesimor, grupi kërkimor shkencor i infermierisë dhe administrata (sekretaria mësimore, personeli mbështetës për laboratorët mesimor, zyra e këshillimi akademik [rregullorja e departamentit të IP dhe rregullorja programit Bsc IP]).</p> <p>Programi Bsc IP është hapur për herë të parë me VKM Nr 105 datë 25.02.1994 dhe është riorganizuar dhe bërë pjesë Fakultetit të Shëndetit me UMASH nr.398 datë 10.08.2011. Në vitin 2016, me vendim Nr. 59 datë 31.10.2016 të Senatit Akademik është bërë riorganizim i pjesshëm i programi Bsc Infermieri e Përgjithshme. Departamenti ofron katër programe studimi një program Bsc dhe 2 programe mastër profesional dhe një mastër shkencor.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e	Drejtuesi i njësisë bazë mbikqyr dhe koordinon aktivitetin mësimdhënës dhe kërkimor shkencor në departament. Me propozim të shefit të departamentit dekani emëron drejtuesin e grupit mesimor dhe kërkimor shkencor të cilët organizojnë dhe ndjekin realizimin e procesit mesimor dhe atij kërkimor shkencor. Në fillim të vitit akademik drejtuesi departamentin cakton këshilltarin akademik dhe




<p>programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>kordinatorin e praktikave klinike për çdo institucion shëndetësor ku kryhet praktika. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit [rregullorja e departamentit, program i studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme] .</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi Bsc në Infermieri e Përgjithshme zhvillohet në Departamentit e Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit. FSHP është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë”. Autoritet drejtuese janë dekani dhe drejtuesit e departamenteve (të zgjedhur), zv dekani, drejtuesit e grupeve mësimor, grupeve kërkimor shkencor dhe këshilltarët akademik të departamenteve (të emëruara). Në përberje të tij janë 3 njësi bazë: dy departamentë si njësi bazë mësimore, qendra kërkimor shkencore, katër laboratorë si njësi ndihmëse dhe administrate (sekretaria mësimore, sekretar dhe personeli ndihmës për laboratorët mësimorë dhe klinikë).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i infermierisë ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo MS dhe staf ndihmës akademik/laborant. Departamenti i infermierisë në tre vitet e fundit ka patur të angazhuar staf akademik si me poshte : Për vitin akademik 2019-2020 ka : 15(pesëmbëdhjetë) pedagogë prej të cilëve 12(dymbëdhjetë) janë PAE dhe 3(tre) pedagogë me kontratë (PAK). Nga stafi PAE 1(një) është Prof As., 3(tre) doktorë në shkencat mjekësore, 2(dy) në proces doktorature dhe 6(gjashtë) Msc/mjek. Nga stafi PAK 1(një) është doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc. Pjesë e stafit të departamentit janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik/laborant me karakter mësimor me Msc dhe MP. Për vitin 2018-2019 : 14(katërbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 11(njëmbëdhjetë) janë Staf PAE dhe 3(tre) petgogë me kontratë. Departamenti ka angazhuar në realizimin e programeve të studimit dhe 2(dy) ndihmës akademik/laborant Msc dhe MP. Nga stafi PAE 1(një) është prof Asc, 3(tre) janë doktorë shkencash dhe 7(shtatë) Msc. Stafi me kontratë 1(një) është doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc. Për vitin 2017-2018 : 13(trembëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 10(dhjetë) janë PAE dhe 3(tre) petgogë me kontratë dhe 1(një) ndihmës akademik MP. Nga stafi PAE 1(një) është prof Asc, 3 janë doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) Msc. Stafi PAK me kontratë 1(një) është doktorë shkencash dhe 2 janë Msc. [RVB, tabela</p>




<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>përmbledhëse nr1]</p> <p>Për realizimin e programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/laboranti me formim e duhur profesional, cili është përgjegjës për organizimin e praktikavë laboratorike mësimore dhe asiston pedagogët në realizimin e tyre si dhe studentët në praktikimin e procedurave të ndryshme infermierore. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike 2017-2020.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit Bsc IP është:</p> <p>Viti 2017-2018 : 46(dyzetë e gjashtë) staf akademik prej të cilëve 42(dyzetë e dy) janë Staf PAE dhe 2 PAK . Nga stafi PAE 1(një) profesor, 6(gjashtë) janë prof Asc, 10(dhjetë) janë doktorë shkencash, 4(katër) janë në proces doktorature dhe 19(nëntëmbëdhjetë) Msc. Stafi PAK me kontratë 2(dy) është doktorë shkencash.</p> <p>Viti 2018-2019 48(dyzetë e tetë) staf akademik prej të cilëve 45(dyzetë e pesë) janë Staf PAE dhe 3(tre) PAK . Nga stafi PAE 1(një) është profesor, 5(pesë) janë prof Asc, 13(trembëdhjetë) janë doktorë shkencash, 4(katër) janë në proces doktorature 22(njëzetedy) Msc. Stafi PAK me kontratë 2(dy) janë doktorë shkencash dhe 1(një) SPA.</p> <p>Viti 2019-2020: 49(dyzetëenëntë) staf akademik prej të cilëve 48(dyzetë e tetë) janë Staf PAE dhe 1(një) PAK. Nga stafi PAE 6(gjashtë) janë prof Asc, 13(trembëdhjetë) janë doktorë shkencash, 4(katër) janë në proces doktoraturë 25(njëzetepesë) Msc. Stafi PAK me kontratë 1(një) është doktorë shkencash.</p> <p>(GVJ konstaton se nga krahasimi i të dhënave në tabelat 6.1; 6.2 dhe 6.39 lista emërore e stafit akademik të programit) me tabelën përmbledhëse nr 7) ka mospërputhje në numrin e pedagogëve. .</p> <p>Stafi akademik ka formimin dhe edukimin e duhur profesional për realizimin e programit mësimor. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ konstaton se ka pedagog që japin lëndë të tipologjive të ndryshme apo që nuk përputhen me formin tyre profesional/specialitetin. psh pedagog me formim në mikrobiologji zhvillon lëndën e farmakologjisë dhe fiziologjisë. Petagog me formim mjek i përgjithshëm zhvillon lëndë</i></p>
---	--




	<p>të specialiteve me tipologji të ndryshme si <i>ORL, mikrobiologji, histologji. Petagog me formim mjek i përgjithshëm zhvillon fizioterapi. Petagog me formim infermier i përgjithshëm zhvillojnë imazheri apo pediatri. Petagog me formim mjek i përgjithshëm i përgjithshëm zhvillon lëndën e dermatologjisë.</i></p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik konstatojmë se pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore 97.7 % realizohet nga stafi akademik efektiv.</p> <p>Mosha e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit është relativisht e re dhe pjesa më e madhe e stafit akademik është në grup moshën 36-55vjeç.</p> <p>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme.</p> <p>Mbështetur në informacionin e mësipërm programi i studimit përbush kryesisht detyrimet ligjore dhe nënligjore që lidhen me angazhimin në institucion, moshën dhe aktivitetin akademik në funksion të programit dhe institucionit në tërësi [RVB dhe rregullorja e DI, Programit Bsc.IP, nagrkesa mësimore, CV stafit akademik]).</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			✓	

Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit e vënë në dispozicion si dhe dokumentave shtesë pas vizitës on line në institucion[evidenca 1.1 programi i studimit bsc infermieri] konstaton se departamenti zotëron, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga petagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore[regullorja e programit të studimit]. Dosja e programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, regullorja e programit të studimit.




<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura programi i studimit Bsc IP përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 3 vite akademike të ndara në 6 semestra. Numri i ETC është 60 ETC për çdo vit akademik, në total 180 ETC.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Bazuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, veprimtaritë formuese, të programit realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara si më poshtë :</p> <ul style="list-style-type: none"> i) Lëndë bazë me 27 ETC (16%) ii) Lëndë karakterizuese 97 ETC (55%) iii) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 22 ETC (14.4) iv) Lëndë plotësuese 12 ETC (11%) v) Detyrime përmblylëse 6 ETC (3.3%) <p>Programi i studimit Bsc në Infermiei të Përgjithshme realizon 22 module dhe kryhen 27 provime për kontrollin e dijeve të fituara nga student. Programi i studimit realizohet në leksione, seminare, praktika mësimore dhe profesionale si dhe për çdo modul/lëndë është i vlerësuar me ETC përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti infermierisë ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me planin mësimor të programit, ngarkesën mësimorë, ndarjen në leksione, seminare, praktika mësimore dhe profesionale si dhe ETC përkatëse për çdo lëndë, orarin e mësimor dhe auditorin ku kryhet lënda përkatëse, ndarjen e orëve sipas semestrave, orët brenda dhe jashtë auditorit të ndarë sipas viteve akademike, rregullat lidhur me frekuentimin e programit ku leksionet janë të detyrueshme të frekuentohen në masën 75% ndërsa seminare, praktika laboratorike/profesionale 100%, mënyra e vlerësimit të studentit, realizimin e provimeve, praktikës profesionale etj[plani mësimor, orari i realizimit të ngarkesës mësimore, rregullorja e programit].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon</p>

ekuivalentimit të studimeve.	kriteret specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM. [rregullorja e FSHP, DI, takimi me studentët].
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga DI ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin bsc IP. Sylabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse.[programi studimit, sylabuset]. Programi ka rregulore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse praktika profesionale është 240 orë në vit/10 ETC. [rregullorja e praktikës].</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton :</p> <ul style="list-style-type: none"> - sylabuset janë organizuar/formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. - në disa sylabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor sipas Ligjit80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 58 “Statusi i personelit akademik”. <p>Në takimin me drejtues të FSHP dhe stafin akademik u diskutua ky shqetësim dhe kjo lidhej me shkaqe objektive si pezullim i promovimit të titujve akademik për një kohë të gjatë nga MARS. Me rifillimin e procedurave për promovimin e titujve akademik ky problem do marrë zgjidhje.</p> <p>Rekomandime: <i>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Infermieri e Përgjithshme ka pësuar riorganizime të cilat janë të miratuara me Vendim Senati nr 59, datë 31.10 2016 “ Për organizimin e pjesëshëm të programe mësimore Bachelor në infermieri përgjithshme dhe Infermieri mami” [evidenca 2.8. Vendim senati. Rishikimi i programit mësimor].</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të përmirësimeve/ndryshimeve të programeve të studimit, argumentimet se përse këto ndryshime janë të nevojshme, diskutime në njësinë përgjegjëse të programit të studimit, aprovimin dhe dokumentimin e plotë të gjithë procedurës së</p>

	ndjekur.[evidenca 2.8 Rishikimi i programit mësimor] .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit bazuar në legjislacionin në fuqi është organizuar në 3 vite akademike, me kohë të plotë , i organizuar në 6 semestra, 180 ETC, nga 60 ETC çdo vit akademik. Një semestër zgjat 15 javë kalendarike. Në fund të programit të studimit studenti i jepet diploma Bsc Infermier i Përgjithshëm. Studenti diplomohet me provim formimi ose temë diplome.</p> <p>Ndarja në kategori (A në F) dhe ngarkesa në krediteve (në%) për veprimtaritë formuese përputhet me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” [dosja e programit].</p> <p>Në total programi ka 180 ETC/4500 orë mësimore prej të cilave 2037 orë mësimore në auditor dhe 2463 orë ose 54.7% jashtë auditorit, punë e pavarur nga studentët. Në programin mësimorë një vënd të rëndë sishëm zë praktika profesionale me 630 orë në total në tre vite akademike. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë. 1 ETC është 25 orë mësimore [Plani mësimor i programit].</p> <p>Forma e mësimdhënies janë leksione, seminare dhe praktikë profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite/orë mësimore. Në tre vite akademike janë 1020 orë leksione, 156 orë ushtrime, 80 orë seminare, 117 orë laboratore, 34 orë projekte dhe 630 orë praktika profesionale [plani mësimor 2017-2020]. Organizmi i praktikës bëhet sipas rregulores së Programit Bsc në infermieri të përgjithsheme. Kohëzgjatja e praktikës mësimore për një modul, në programin BSc është 2 ose 4 orë në javë në vartësi të ETC që ka moduli. Praktika profesionale sipas planit mësimor është 8 orë në javë. Grupet për realizimin e praktikës mësimore dhe profesionale përbëhen nga 20 studentë.</p> <p>Proçesi mësimor zhvillhet në bazë kursi dhe grupi sipas kriterëve të</p>

	<p>miratuar nga MARS grupet e leksioneve 80-100 studentë, seminarët</p> <p>40-50 studentë, laboratorët 8-15 studentë, praktika mësimore 25-30 studentë, praktika profesionale 30-50 studentë. Ora mësimore është 60(50+10)minuta.</p> <p>Orari mësimor dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga njësia bazë dhe miratohet nga titullari i institucionit.</p> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament. GVJ konstatoi së 97.7% e programit mësimor realizohet nga PAE [plani mësimor, ngarkesa mësimore e pedagogëve].</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës mësimore në laboratorët didaktikë dhe praktikës profesionale pranë shërbimeve klinike përbëjnë 50% të orëve në auditor. Këtij qëllimi i shërben dhe rishikimi i lëndës “Bazat e infermierisë” me shtim të orëve të praktikës mësimore nga 30 orë në 75 orë [dosja e programit]</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre [takimi me studentët].</p> <p>Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin Bsc në “Infermieri të Përgjithshme”. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit të përgjithshëm dhe bazë në infermieristikë. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të formimit profesional sipas specialiteve. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional[programi i studimit/planimësimor].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e</p>	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare, ndryshime të vogla ka vetëm në numrin e ECTS për lëndë. Fillimisht programi është organizuar sipas programit</p>




<p>programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>italian. Në vitet e fundit për rditësimi i programit është bërë në bashkëpunim me kolegjin Sandhill Community Collge. Programi i Bsc infermier i përgjithshëm është i njëjtë me programin e Fakultetit të shkencave teknike në Universitetin Mjekësor të Tiranës [Referuar RVB, takimit me stafin drejtues të FSHP, DI dhe stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjisllacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brënda dhe jashtë vëndit. Strukturimi i vazhdueshëm i programit me qëllim formimin profesional të infermierit, licensimin dhe punësimin në tregun e punës ka ndihmuar në njohjen e programit në vënde të BE, USA Canada dhe integrim në tregun europian. Në takimin me pëdagogë dhe studentë u referua se një numër studentësh të këtij programi kanë kryer motilitet në programet erasmus dhe u janë njohur të gjitha ETC e fituara në universitetet pritëse. [evidenca e rogramit mësimor në Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, tabelat e transferime nga/në FSHP, proçedura e njohjes së krediteve në kuadër të mobiliteti nga programet erasmus, raportet e urdhërit të infermierit mbi punësimet në tregun vëndas dhe të huaj].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>FSHP dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo sylabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar [neni 29 rregullorja e FSHP]. Departamenti ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekse mësimorë të pedagogëve të UV apo UMT, cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës . Tekset mësimorë për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjëndet në fund të çdo syllabusi. Format i hartimit të tekseve mësimore është i miratuar me vendim të senatit akademik. Ne takimin me pedagogët u referua që po punohet për sigurimin në platformë online të literaurës ndihmëse për studentë.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës, aftësimin profesional teorik dhe praktik. Ne takimin me drejtues të institucionit dhe të departamentit u referua se DI po punon për përditësimin e</p>




studimit të ciklit të parë.	kurikulës dhe përshtatjen e plotë të saj me direktivën 2013/55EU të Parlamentit European për njohje të plotë të diplomave të fituar nga FSHP			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive bazë në infermieri të përgjithshme dhe thellimin e njohurive të përftuara në ciklin e parë të studimit në kualifikime të mëtejshme.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Realizmi i programit bën të mundur përfitimin e shprehive dhe aftësive të duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre. Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për formimin e tyre profesional në ushtrimin e profesionit të infermierit në shërbime të ndryshme klinike dhe në çdo grup moshë, si dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës. [rregullorja programit, plani mësimor, orari mësimor].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në programin Bsc Infermieri e Përgjithshme përmbush këkesat ligjore në fuqi. Ai përbëhet nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur profesional për lëndët përkatëse që zhvillohen në program. Kategorizimi i pedagogëve në lektorë, asistentë lektor apo titullarë lëndë bazohet në ligjin e arsimit të lartë bazuar në gradën apo titullin akademik që ka petagogu. Të gjithë lektorë janë të kategorisë profesor dhe me gradën “Doktorë shkencash” dhe asistentë lektorë janë me “Master shkencor”. Personeli i angazhuar në programet e ciklit të parë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UV, bazuar në udhëzimin nr 37, datë 4.12.2018 për një ndryshim në udhëzimin Nr. 29, datë 10.9.2018 “Për veprimtarinë dhe

	<p>ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Çdo anëtar i personelit PAE përmban deri në 3(tre) lëndë në semester në bazë të programeve të përcaktuar nga njësia bazë. Nga shqyrtimi i dokumntacionit GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve bëhet duke pasur parasysh që anëtari i personelit akademik të mos zhvillojë më shumë se tre lëndë në semester.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i njësive bazë i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për të mbuluar ngarkesën mësimore të programeve të studimit. Personeli akademik efektivë dhe me kontratë që angazhohen në realizimin e programit të studimit, si titullarë të lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj. Për vitin akademik 2019-2020 në programin Bsc. Infermier i Përgjithshëm janë angazhuar 49 pedagogë PAE dhe PAK : Prej tyre 48(dyzetë e tetë) janë PAE dhe 1(një) PAK. Nga stafi PAE 6(gjashtë) janë prof Asc, 13(trembëdhjetë) janë doktorë shkencash, 4(katër) janë në proces doktoraturë 25(njëzetepesë) Msc. Stafi PAK me kontratë 1(një) është doktorë shkencash. Raporti PAE/PAK është 48/1.</p> <p>Siç e kemi theksuar në standartin II.2 kriteri 5, GVJ konstaton se nga krahasimi i të dhënave në tabelat 6.1; 6.2 dhe 6.3(lista emërore e stafit akademik të programit) me tabelën përmbledhëse nr. 7 ka mospërputhje në numrin e pedagogëve në këtë program studimi]</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve.</p> <p>Pjesa kryesore e pedagogëve të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë pedagogë me grada dhe tituj. Përzgjedhja e pedagogëve që japin një lëndë të caktuar është bazuar në ekspertizën akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies [procedura rekrutimit të stafit akademik]. Të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në programin Bsc. Infermieri e Përgjithshme zhvillojnë lëndë në përputhje të plotë me fushën e tyre të specializimit. <i>Programi përbëhet nga 22 module prej të cilave 11 module kanë titullarë lëndë të kategorisë professor dhe 11 module doktorë shkencash. Bazuar në Ligjin 80/2015 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë' neni 58 "Statusi i personelit akademik, titullari i lëndës është i kategorisë professor.</i> [shif standarti II.3] [evidence program mësimor, tabelat 12 ASCAL,</p>




	Evidence 2.25 komunikim shkresor i dekanes së FSHP me departamentet e kimisë dhe biologjisë]
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale, UV ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione publike shëndetësore, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të fushës në auditor. Mbikëqyrja dhe ndjekja e praktikës profesionale realizohet nga petagogu i praktikës dhe personi përgjegjës i institucionit shëndetësor ku kryhet praktika.</p> <p>Drejtuesi i departamentit ndan grupet e praktikës pedagogëve përgjegjës. Titullari i lëndës prezanton petagogut të praktikës sylabusin dhe objektivat përkatëse. Petagogu përgjegjës për praktikën përgjigjet për organizmin, realizon mësimdhënien klinike dhe monitoron kryerjen e praktikës profesionale në bashkëpunim më personin përgjegjës të institucionit shëndetësor. Student inormohet në fillimi të praktikës nga pedagogu përgjegjës mbi organizmin, realizimin e praktikës dhe vlerë simin përfundimtar.</p> <p>Studentët që përmbushin kriteret e mesatares së notës dhe detyrimet ndaj Fakultetit të Shëndetit diplomohen duke mbrojtur temë diplome. Në fillimin të semestrit të fundit të programit Bsc në Infermieri e Përgjithshme grupi i kërkimit shkencor përcakton temat dhe udhëheqsit e tyre dhe ja paraqet për miratim drejtuesit të departamentit.</p> <p>Studentët e interesuar paraqesin kërkesë pranë departamentit përkatës.</p> <p>Drejtuesi i departamentit ngre komision “ad hoc” i cili verifikon kriteret që duhet të plotësojë studenti që mbron teme diplome dhe ja paraqet për miratim drejtuesit të departamentit.</p> <p>Lista e studentëve dhe udhëhëqësit e tyre i paraqitet për miratim drejtuesit të departamentit dhe dekanit të fakultetit.</p> <p>Përgatitja e temës së diplomës dhe formatimi i saj janë përcaktuar në shtojcën 1 të rregullores manuali i përgatitjes së temës së diplomës.</p> <p>Pedagogu që udhëheq diplomën e studentit në ciklin e parë të studimeve duhet të ketë diplomën “Mastër shkencor” [Regullorja e DI].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve</p>	<p>Për realizimin e praktikës laboratorike mësimore institucioni ka angazhuar personel akademik ndihmës me formimin përkatës në infermieri. Departamenti i Infermierisë ka dy staf akademik ndihmës për realizimin e praktikës mësimore në laboratorët didaktikë të anatomisë dhe infermierisë me formim infermier.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Laboranti është përgjegjës për organizimin e praktikës mësimore, sigurimin dhe mirë mbajtjen e bazës së nevojshme materiale, asiston pedagogun gjatë relizimit të praktikës si dhe studentët në kryerjen e procedurave të ndryshme infermierore. Detyra e stafit ndihmës janë përcaktuar në nenin 22 të rregullores së FSHP, [takimi me stafin akademik dhe vizita online ne ambientet e laboratorëve].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	UV ka hartuar rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit [rregulloret] . Rregullorja e programit të studimit, përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive. GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentët konstatoi se në program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online bazuar në udhëzuesin për përdorimin e metodave të mësimdhënies dhe strategjine integritit dhe trajtimit të stafit të UV. [takimet me stafin dhe studentët, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, moduleve dhe lëndëve” dhe “Strategjia integritit dhe trajtimit të stafit të UV”].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë	Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>në funksionim NJSBC e cila në bashkëpunim me Zv/ Rektorin për Proçesin mësimor, Dekanët, Drejtuesit e Departamentit dhe Sekretarinë mësimore kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrative. Në mënyrë të vazhdueshme monitorohet proçesi i mësimdhënies duke ndjekur zhvillimin e leksioneve, seminareve, praktika mësimore në auditor nga drejtuesi i departamentit, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit si dhe intervistës individuale me secilin pedagogë të brëndshën apo të jashtëm lidhur me kryerjen nga pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur</p> <p>[Statusi UV, Regullorja e DI, RVB, takimi me stafin akademik, formularët e vlerësimit, evidence 3.6 proçese verbale te drejtuesit të departamentit].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>NJSBC monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike proçesin mësimor, aftësitë e stafit akademik duke përfshirë dhe studentët në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve duke u bazuar në pyetësonin e studentëve. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për proçesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. Çdo vit në analizën vjetore te deparatmetit paraqiten rezultatet e monitorimit të proçesit të mësimdhënies nga drejtuesi DI dhe rekomandimet e NJSBC. Në takimin me NJSBC dhe stafin akademik u theksua se është në proçes dhe përgatitja e pyetësore për vlerësime nga stafi akademik.</p> <p>[Statusi UV, Regullorja e DI, takimi me stafin akademik, formularët e vlerësimit, evidence 3.6 proçese verbale te drejtuesit të departamentit, evidence Informacion i NJSBC].</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC pas përpunimit statistikor të pyetësorëve nxjer përfundimet e pyetësorit dhe bën rekomandimet përkatëse. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët për çdo fakultet bëhen publike për të gjith stafin dhe studentët në ëbsite e UV. Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimt të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin</p>	<p>Për promovimin e shëmbujve dhe praktikave më të mira institucioni përdor mënyra të ndryshme si trajnime të stafit akademik lidhur me përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies (përdorimi i manikave simulatore, tabelat smartboard etj), rifreskim të njohurive lidhur me kërkesat dhe</p>




akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	standartet e cilësisë, metodat e mësimdhënies, përfshirjen në projekte të ndryshme për trajnime lidhur me metodat e mësimdhënies si përfshirja në programin Erasmus + të pedagogëve, etj. [Evidence3.12 Për mobilitetin e programet Erasmus + në universitetin Tallinn e 4 pedagogëve, evidence 3.14 evidenca e projektit e-learning in 3D; Evidence 1.6. Analiza vjetore e departamentit të infermierisë, evidence 3.13 Qendra simulatore për trajnim shëndetësor; Udhëzuesinë nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, moduleve dhe lëndëve” dhe evidenca 3.1 “Strategjia integritit dhe trajtimit të stafit të UV”].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në realizimin e procesit mësimor programi Bsc në “Infermier i përgjithshëm”, përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si [RBV, takime stafin akademik, regullorja e programit Bsc IP]. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore dhe profesionale. Personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. [Regulorja e DI, Regullorja e programit të studimit]
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në	

veçanti.	
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të programit janë laboratorët mjekësorë të infermierisë dhe anatomisë dhe qendra simulatore, të nevojshem për zhvillimin e praktikave laboratorike mesimore . FSHP dhe DI çdo vit parashikojnë një buxhet të veçantë për shtimin apo përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Burime të tjera financimi përveç buxhetit nga UV janë projektet e ndryshme të fituara si projekti me AKKSHI –n për infrastrukturën mësimdhënëse, projektet Erasmus për zhvillimin e kapaciteteve.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperincën mjekësorë apo petagogjike në lëndët që zhvillojnë [CV e stafit akademik]. Metodatat e përdorura në funksion të secilës lëndë janë leksione me paraqitje me poër point, shkrim në tabelë, fotoprojektorë, seminarët ku një rëndësi i jepet pjesmarjes së studenteve në diskutime interaktive apo në laboratorë ku studentë përfshihen në kryerjen vetë në mënyrë të pavarur të manipulimeve të ndryshme në manikina, apo kryerjen e procedurave të ndryshme infermiore(praktika profesionale). Siç është përmendur dhe në standartin II.2 GVJ nga shqyrtimi i ngarkesës mesimore të pedagogëve dhe planit mesimor konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. <i>GVJ rekomandon të rishikohen ngarkesa mesimore dhe shpërndarja e lëndëve që zhvillojnë pedagogët sipas formimit profesional që kanë.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i DI, ku zhvillohet ky program studimi. Për këtë qëllim çdo vit departamenti ngrë një grup pune për mbledhjen e kërkesa lidhur me metodat e mësimdhënies, i diskuton në departament dhe përcaktojnë buxhetin e nevojshëm i cili i paraqitet strukturave drejtuese të FSHP. Një vënd të rëndësishëm në përgatitjen e buxhetit zënë dhe propozimet e bëra nga studentët, këshilli studentorë si dhe rezultatet e pyetsorit të studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies [takimi me stafin akademik, studentët dhe grupin kërkimor shkencor] .
Kriteri 6. Personeli akademik	Personeli akademik për ta bërë tërheqëse orët e mësimit përdor

përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	metoda interaktive dhe diskutimin e rasteve, përdorimin e videoprojektorëve apo ushtrimeve të ndryshme në punët laboratorike të cilat janë më atraktive për studentitn. Me interes për studentët janë diskutimi i rasteve klinike në Leksion, seminare apo praktika [takimi me stafin akademik dhe studentët] .			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit dhe inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Gjatë procesit mësimor, praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematikat kryesore të shërbimit shëndetësor sidomos në specialitet që përputhen me këtë program studimi. Pedagogët përdorin metoda të ndryshme për të inkurajuar studentët të punojnë në mënyrë të pavarur si : -kryerja në mënyrë të pavarur të procedurave të ndryshme gjatë orëve të praktikave mësimore apo laboratorike, - përgatitja e detyrave të kursit ku studentët paraqisin raste klinike të përgatituar vet në mënyrë të pavarur. - praktikimi i tyre në manikinat simulatore e cila ju sigurojnë studentëve vetbesimin në dijet e fituara, praktikimin e aftësive profesionale, marrjen e vendimeve në realizimin apo zgjedhjen e procedurave të ndryshme infermiere pa ndikuar në jetën e pacientit. -organizmi i studentëve në grupe të vogla si dhe asistimi i tyre nga personeli ndihmës akademik gjatë praktikës ç'ka ju mundëson studentëve të kryejnë vetë procedura infermiere gjatë praktikës. [takimi me stafin akademik dhe studentët, regullorja e programit të studimit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. [vizita e ambienteve]

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>FSHP ka një sipërfaqe reth 3200m² për 1100 studentë. Proçesi mësimor realizohet në dy fasha orare duke siguruar standartin 5 studentë/m² bazuar në VKM 418, datë 10.05.2017. Ambiente ku zhvillohet proçesi mësimor kanë logjistikë e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimin, tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në funksion të programit janë laboratorët mësimor i infermierisë dhe anatomisë. Laboratori i infermierisë është i pajisur me gjithë pasigjet e nevojshme për aftësimin e studentëve në kryerjen e proçedurave të ndryshme infermiore si manikina, simulatore etj. Ambientet mësimore dhe sekretarisë janë rikonstruktuar, areduar dhe konceptuar në funksion të detyrave që realizojnë. Zyrat e stafit akademik janë të pajisura me kompjutera, printera, fotokopje që përdoren në funksion të proçesit mësimor. [vizita on line e ambienteve, raporti ekspertëve për infrastrukturën UV, RVB]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj. Gjithashtu institucioni ka siguruar abonim në bibliotekën online. Fizikisht në bibliotekë gjenden 15 poste me kompjutera për shfrytëzimin e kësaj biblioteke. Staf i akademik ka ambiente pune të pajisur me kompjutera personal dhe Wi-Fi. Studentët mund të përdorin kompjutrat në bibliotekën e UV ose të shfrytëzojnë ambientet e sallave të studentëve në fakultetet e tjera të universitetit. [evidence 3.28 Lista e pajisjeve audiovizive në funksion të programit Bsc Infermieri e Përgjithshme. 3.29 Evidenca. Lista e pajisjeve të laboratorëve të infermierisë 3.30 Lista e pajisjeve të laboratorit të anatomisë]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Studentët për marrjen e njohurive të parashikuara në këtë program studimi kanë në dispozicion literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj. Literatura bazë është në gjuhën shqipe dhe gjendet në fund të çdo syllabusi për çdo lëndë apo modulë. Përveç literaturës në gjuhën shqipe studentët kanë dhe literaturë ndihmëse në gjuhën angleze. Literatura vihet në dispozicion në formën e teksteve mësimore apo cikël leksionesh të përgatitura nga stafi akademik i programit. Gjithashtu studentët përdorin tekste të pedagogëve të UM të Tiranës. Literatura dhe tekstet mësimore që do të përdoren nga studentët miratohet në fillim të çdo viti akademik nga drejtuesi i departamentit të infermierisë. Nga vizita në bibliotekën e fakultetit u referua se nga studentët përdoret shumë literatura në gjuhën e huaj sidomos angleze prandaj po punohet që kjo literaturë të sigurohet nga biblioteka on line [dosja e programit mësimor, evidence 3.43. Lista e literaturës për</p>




	FShP, takimi me stafin e bibliotekës].
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të studenteve dhe personelit akademik bibliotekën e UV. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se biblioteka ka një literaturë mjaft të pasur dhe disponon 15 mijë tekste në gjuhën shqipe dhe 35 mijë në gjuhën angleze. Biblioteka është e organizuar dhe skeduar në mënyrë profesionale nga stafi i bibliotekës ku vlen të theksohet se ai kishte një eksperiencë të gjatë pune.</p> <p>Literatura në bibliotekë përditesohet sipas kërkesës së Dekanatit. Çdo vit dekanati përcakton një buxhet të vecantë për blerje literature dhe përgatit kërkesa me titujt e librave në funksion të programit të studimit në Inferimeri të Përgjithshme. Përveç literaturës në gjuhën shqipe ka dhe në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht. Literatura në gjuhën e huaj është kopje unike dhe shfrytëzohet nga stafi dhe studentët vetëm në ambientin e bibliotekës. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik [vizita e ambieteve ne institucion]. Institucioni i siguron Studentëve dhe pedagogeve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë. [3.43. Lista e literaturë spër FShP. Evidence 3.44 Lista e tesktseve të botuara nga stafi akademik, FSHP, Evidenca 3.45 Kërkesa buxhetore e FSHP. Evidenca 2.16 Kërkesa për blerje të teksteve mësimore]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në lidhje me infrastrukturën on line, institucioni ka faqen zyrtare të institucionit në të cilën publikohen informacione dhe njoftime të ndryshme. Në funksion të procesit të mësimdhënies funksionon faqja online e bibliotekës <i>ëëë. ulibrary.rash.al</i> me regjistrim paraprak dhe me email. Studentët dhe stafi akademik kanë akses me përdorim të teksteve apo revistave nga librari të akademike apo institucioneve të ndryshme arsimore. Këto janë aritur në kuadër të bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkta me këto institucione. [evidenca 3.46 Raporti i zyrës së IT. Evidenca 47 Tabela 17 ASCAL. Evidenca 3.41 Informacion i bibliotekës shkencore]</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni ka strukturën e nevojshme laboratorike për shkencat mjekësore në funksion të studentëve dhe stafit akademik për realizimin e detyrave të kursit apo temave të diplomës. Laboratorët (6 laboratorë) qëndrojnë hapur nga ora 8⁰⁰-16⁰⁰ dhe kanë në dispozicion 3 laborantë me kohë të plotë që asistojnë studentët në realizimin e praktikave mësimore, temave të diplomës apo detyrave të kursit. Studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit përdorin dhe kompjuterat dhe infrastrukturën e bibliotekës e cila qëndron hapur nga ora 8⁰⁰-20⁰⁰</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	[Evidenca 3.41 Informacion i bibliotekës shkencore. Takimi me stafin e bibliotekës dhe studentët]
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) Medscape Nurse i cili shërben si burim informacioni për punonjësit e sistemit shëndetësorë dhe edukimin profesional në disatncë me ETC. Stafi akademik inkurajon studentët të bëhen pjesmarës në këto platforma online duke bërë dhe rekomandime konkretë siç është platforma on line Roseta Stones. Studentë të FSHP kanë marrë pjesë në platformën e trajnimit e-learning për duhanpirjen organizuar nga UV. [Evidence 3.48 Platforma e trajnimeve e-learning. Takime me stafin akademik]
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë rezultoi se institucioni ka në përdorim sistem menaxhimi të informacionit, dhe platformën UMS të komunikimit të brëndshëm elektronik apo platformë në funksion të bibliotekës online apo trajnimeve me platformn e-learning sipas përcaktimeve të Standardit III.3. Çdo student ka llogarinë e tij elektronike ku mund të regjistrohet në lëndët që dëshiron të frekuentojë gjatë vitit akademik, mer informacion për rezultatet e provimeve, apo lekione të vendosura on line nga pedagogët.[Evidenca 3.49-3.50 llogari UMS e petagogu dhe studenti. Evidenca 3.51-3.52 Manuali i përdorimit të portalit UMS nga studentët dhe pedagogët]. Temat e diplomës zgjidhen nga grupi i kërkimit shkencor dhe miratohen nga departamenti. Temat zgjidhen të lidhur me problematikat aktuale të sistemit shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale dhe mundësive aktuale për realizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Institucioni ka një rregullore për procedurën e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomës dhe vlerësimin e saj [udhëzuesipër punimin e temës se diplomës] . Udhëheqësi shkencor orienton dhe asiston studentët në realizimin e temës së diplomës dhe përgatit me shkrim mendimin për studimin e realizuar dhe përputhjen e tij me programin e studimit i cili depozitohet në sekretarinë mësimore. [Rregullorja e departamentit të IP, rregullorja e programit mësimor, rregullorja “Manuali për përgatitjene temës së diplomës] .
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentët që plotësojnë mesataren e vendosur nga Senati akademik mbrojnë diplomën me temë diplome. Departamenti ka një procedurë të mirëpërcaktuar për zgjedhjeve temave të dilomës. Temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës përcaktohet nga grupi kërkimor shkencor dhe i paraqiten për miratim drejtuesit të departamentit. Pas miratimit të tyre ato i dërgohen sekreatrisë mësimore ku ky informacion ju vihet në dispozicion studentëve të interesuar. Studentët asistohen nga

	pedagogët për zgjedhjene e temës së diplomës dhe realizimin e temës së diplomës. Studenti dhe pedagogu pasi bien dakord për temën e zgjedhur sëbashku firmosin formularin përkatës dhe e dorëzojnë në department. Përgatitja, shkrimi i temës së diplomës bëhet sipas kriterëve të miratuar ne regulloren “Manuali i përgatitjes së temës së diplomës”[regullorjae DI, Neni 54].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UV/Fakulteteve/departamenteve/ programeve të studimit të cilat janë në funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UV. Njësia kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë është NJSBC dhe Qendra e kërkimit shkencorë përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafi akademik Institucioni ka NJSBC e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i UV dhe e ndjek atë në vitin pasardhës NJSBC-ja harton raporte vjetore dhe tre mujore të cilat janë detyrim institucional. [Evidenca 3.9.Informacion i NJSBC. Takimi me stafin e NJSBC, Statusi UV. Rregullorja e FSHF, Departamentit /programit. Evidenca 3.9.Informacion i NJSBC]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Infermierisë është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të mësimin në Bsc infermier i përgjithëm. Departamenti zhvillon në mënyrë periodike mbledhje për diskutimin e standarteve të cilësisë, problematika lidhur me menaxhimin e programeve të studimit që mbulon departamenti. [mbledhja vjetore e departamentit]
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin	Departamenti IP si njësi përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e pjesës së praktikës mësimore apo zhvillimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në këtë program studimi zhvillohet mësimdhënia me anë të manikinave apo simulatorëve, hartimi modelit të kartelës infermiore. Realizmi në grupe i praktikës klinike apo aplikimi i platformës elektornike e-learning.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni nëpërmjet NJSBC në bashkëpunim dhe njësitë bazë/grupin kërkimor ku zhvillohen programe të ndryshme të studimit, siguron program trajnimi për stafin akademik në përputhje me kualifikimin e tyre dhe gradën shkencore. Këtij qëllimi i shërbejnë aktivitetet me qëllim trainimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor, projektet dhe metodologjinë apo aktivitet të edukimit të vazhdueshëm. [lista e aktiviteteve trajnuese të stafit akademik te DI.]
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	FSHP dhe DI trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Institucioni mbështet financiarisht pedagogët në trajtimin e aftësive të tyre mësimdhënëse dhe profesionale duke ju siguruar ndjekjen e projekteve apo aktiviteteve të ndryshme trainuese apo në botime të punëve të tyre në revista të ndryshme. [takime me stafin akademik, strategjia e integritit dhe trajnimittë stafit akademik të UV. Trajnim për ritjen e kapaciteve të stafit akademik te FSHP, Lista e trajnimeve]
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies, përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe implementimin e metodave të reja bazuar në rregulloren e DI dhe programit të studimit për IP. Çdo vit përgatisin kërkesat dhe buxhetin përkatës për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe ja paraqesin strukturave drejtuese të dekanatit.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe	Stafi akademik në bashkëpunim me stafin ndimes akademik testojnë dhe përdorin metoda të reja mësimdhënëse si aplikimi i praktikës klinike në grupe, testimi në klinikë i tipit të ri të karteles infermiore, aplikimi i manikinave simulatore në praktikën mësimore etj. Të gjitha këto teste i shërbejnë aftësisë praktik të studentëve dhe ritjen e cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet e

raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	këtyre testeve diskutohen dhe paraqiten në department në mënyrë periodike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjith bazën e nevojshme ligjorë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve te cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion në ëbsite e UV [rregulloret e departamenti/regullorja e provimeve dhe diplomimit]			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen nga këshilltari akademik në fillim të vitit akademik dhe titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHM si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. [takimi me studentët, rregullorja e programit të studimit].			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/praktika, provimi diplomimit. Teza e provimit përmban dy formë pyetjesh që janë kuice dhe pyetje shtjelluese duke krijuar mundësinë studentit të shprehet në çdo formë. Proçedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së provimeve / regullorja e departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që student mer gjatë gjithë semestrit/akademik si vijon: a. Provimi i pjeshëm në javën e VII-VIII (30%) b. Provimi i vazhdueshmë nga seminarët apo mbikqyrësi praktikës (10%) c. Provimi përfundimtar në fund të lëndës në javën 15 (60%).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Praktika vlerësohet më notë në provim përfundimtarë ku studenti demonstron në manikat simulatore të laboratorëve aftësitë profesionale të përfituara gjatë programit të studimit. [program i studimit, skeda e vlerësimit të provimeve, proces verbalët e notave] Institucioni ka infrastrukturën e nevojshme për aplikimin e formave on line të testimeve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Tesimi i dijeve përfundimtarë realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar programin. Provimi me goje realizohet nga komision i përbërë nga tre pedagogë. Ndërsa provimi me shkrim realizohet me praninë e së paku të dy pedagogëve në varësi të numrit të studentëve dhe sallës në dispozicion. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrolllohet nga titullari i lëndës dhe miartohet nga përgjegjësi departamentit. Çdo pyetje vlerësohet më pikët maksimale që meren prej saj. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit. Sekretaria mësimore nxjerr frekuentimin e leksioneve, seminarë dhe praktikave të studentit si dhe konfirmon realizimin e pagesave që ka detyrim studentit përpra se ai të hyjë në provim.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Proces verbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. [regullorja e departamentit dhe programit të studimit] Testimi i dijeve kryhet me shkrim, në mënyrë anonime me sekretim sipas regullores së departamentit të infermierisë. Mënyra e testimit pasqyrohet në çdo sylabus lënde. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e aritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve studentëve. Në këto séance pedagogu mundëson studentit nëse ky dëshiron, të shikoj rezultatet e provimit. Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në	

provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse konstatohet kopjim në provim apo detyra kursi studenti i jepet vërejtje dhe i zerohet rezultati i provimit. [Regullorja e departamentit dhe programit të studimit]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. [takimi me studentët]. Rezultatet komunikohen nga petagogu sipas afateve të përcaktara në rregulloren e provimit brënda 48 orëve në sistemin UMS. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyre konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin UMS. Nesë provimi realizohet me gojë rezultati mëret menjëherë pas provimit.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejte të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës në sekretarinë mësimore brënd 48 orëve pas marjes së rezultatit, sipas procedues të miratuar në rregulloren përkatës të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të departamentit i cili bën verifikimet e duhura dhe nëse nuk zgjidh ankesën vë në dijeni dekanin Dekani brënd 48 orëve ngre komision "ad hoc" për verifikimim e ankesës së studentit dhe bën verësimin e provimit. Nëse provimi është zhvilluar me gojë studenti përsërit provimin në parni të komisionit "ad hoc" duke tërhequr një teze të dytë. Vlerësimi në këtë provim mbetet vlerësimi përfundimtarë i studentit. Ndryshimi i rezultatatit të provimit pasqyrohet në proçes verval të frimosur nga komisioni "ad hoc" dhe i bashkangjitet vlerësimit të komisionit të mëparshëm dhe sistemin UMS. [regullorja e UV, regullorja e departamentit, regullorja e programit mësimor] E gjithë procedura e ankesës dhe rivlerësimi i studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore, dhe në zyrën e kryesekretarit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓




Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë bachelot në IP është 3(tre) vite akademike, 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS është 25 orë mësimore punë të studentit. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. volumi që zënë orët e praktikës mesimore dhe profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre rofesionale dhe të praktikohenn gjatë manipulimeve në manikina apo simulatorë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithsmë si gjuha e huaj, teknologji informacioni dhe komunikimi. [programi mësimor]</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkuesë të studentët sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtarë të punës. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësite profesionale të fituara nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, departamneti në bashkëpunim me departamentët e tjera të FSHP si dhe mjekë nga institucione shëndetësorë apo institucione arsimorë vëndase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor</p>




	<p>ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjëmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët të cilët paisen në fund të aktivitetit me çertifikatën përkatës të pjesmarjes.</p> <p>Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [takimi me studentë dhe pedagogë, lista e aktiviteteve në tre vitet e fundit, leksione të hapura në pedagogë nga BE, çertifikata të studentëve për pjesmarje në këto aktivitete].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në programi Bsc në Infermieri të Përgjithshme janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie.</p> <p>Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit dhe për tu përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit/legjisacionit për pranimin e përgjegjësi apo vendimeve individuale lidhur me gabime të mundëshme në praktikë, raportimin dhe marjen e masave korigjuese.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor.</p> <p>Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve gjatë diskutimeve të rasteve klinike në seminare, praktikave mësimore dhe veçanërisht ato profesionale</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e UV apo sallat e kompjuteravë të fakulteteve të tjera brënda UV dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme kërkimi, në realizimin e testeve në komunitet ku ata përfshihen në plotësimin e pyetësoreve të ndryshëm, mbledhjen e të dhënave në spital nga kartelat apo regjistrat , përfshihen në grupet e përgatitjes/shkrimit të projekteve të ndryshme [takimi me studentët dhe staf akademik].</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve</p>	<p>Publikimi i rezultateve të projekteve të ndryshme të paraqitura në aktivitete në formë posterit apo botime në revista ku janë</p>

inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	përfshirë edhe studentët mbështeten financiarisht nga UV [takimi me studentët dhe staf akademik, anaiza vjetore e departamentit].			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Një element i rëndësishëm në këtë program studimi është realizimi në gjuhën angleze i modulit “Principet bazë në infermieri” ç’ka ju mundëson studentëve përfshirjen në programet e mobilitet, përshtatjen në tregun europian të punës apo dhe mundësinë e ardhjes të studentëve të huaj në këtë program. Në kuadër të marveshjeve dhe projekteve të mobilitetit të studentëve që ka UV me IAL në vëndet e BE, student nga ky program kanë realizuar modulën e praktikës profesionale në universite në spanjës, Greqi dhe Estoni. Në këto vëndë nuk mund të realizohen module të tjera pasi në këto institucione programet nuk zhvillohen në gjuhë angleze. Është bërë e mundur realizimi i mobilitetit të studentëve në 4 module në IAL në Lion dhe spanjë ku program mësimor zhvillohet në gjuhën angleze dhe janë në përputhje të plotë me planin mësimor në programin Bsc Infermier i përgjithshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome Bsc infermieri përgjithshëm pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës dhe formatit të saj. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e departamentit të Infermierisë dhe të programit të studimit në të cilën përshkruhet qartë proçedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit. [rregullorja e diplomimit, rregullorja e punimit të diplomës].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	Fokusi i programit Bsc në IP, është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtarë ose në përgatitjen e një teme diplome. Pedagogët i orientojnë studentët dhe ju japin informacion lidhur me temat apo materiet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzohen në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantim e materialit.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit duke përfshirë 8 (tetë) lëndë në bazë të peshës specifike të tyre në program. Teza e provimit përmban pyetje shtjelluese dhe kuice. Provimi bëhet me shkrim dhe monitorohet nga grupi i pedagogëve të caktuar nga departamentit. Pedagogët që monitorojnë provimin nuk janë pjesë e grupit të korrigjimit të provimeve. Korrigjimi i provimit përfundimtar kryhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3-5 vetë të miratuar nga dekani i fakultetit. Proçes verbali përfundimtarë i rezultatit të provimeve firmoset nga komisioni i vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari. [regullorja e departamentit neni 54].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> <p>2-3 muaj përpara përfundimit të studimeve departamenti përcakton lëndët e formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe me zgjedhje që do përfshihen në provim dhe titullari i lëndës përcakton temat që do përfshihen në provim të cilat do përbëjnë fondin e pyetjeve të provimit. Këto ju vihen në dispozicion studentëve në ëbsite e UV, afishohen në ambientet e departamentit. Studenti informohet për fondin e pyetjeve dhe mënyrën e vlerësimit dy muaj përpara përfundimit të semestrit struktura e tezës së provimit përcaktohet në nenin 19 të regullores të programit të studimit. Shum totale e pikëve të pyetjeve që përfshihen në tezën e provimit të diplomës është 100 pikë. Grupi kërkimor shkencor i programit përcakton temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës të cilat pasi miratohen në departament ju vihen në dispozicion studentëve. Studentët asistohen nga pedagogët udhëheqës së temës së diplomës gjatë hartimit dhe realizimit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston</p>	<p>Ralizmii temes së diplomës bazohet në regulloren e departamentit</p>




studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	“Manuali i përgatitjes së temës së diplomës”. Institucioni i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësore që realizohet studimi ose realizojnë pjesën eksperimentale në laboratorët e departamentit. Leja etike për realizimi e studimit jepet nga dekanati i FSHP.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Petagogu udhëheqës asiston dhe orient studentit në realizimin e temës së diplomës e cila konsiston hartimin e strukturës së temës, metodologjinë e hartimit, shkrimin apo prezantim e studimit, në përzgjedhjen e literaturës për pjesën teorike, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre, përpunimin statistikor, etj. Udhëheqësi i temës garanton vërtetësinë dhe cilësinë e rezultatit dhe jep miratimin me shkrim për paraqitjen e temës në komisionin e vlerësimit i cili dorëzohet në sekretarinë mësimore. [regullorja e programit, manuali i përgatitjes së diplomës]
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtarë i provimit të diplomës apo temës bëhet me notë. Teza e provimit të diplomës ka 100 pikë maksimale. Teza korigjohet nga komisioni vlerësimit i përbërë nga 3-5 vetë. Proçes verbali përfundimtarë frimoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara jurisë së komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Prezantimi i temës së diplomës është i hapur dhe koha e prezantimit është 30 minuta. Pas prezantimit paraqësin mendimin oponentët dhe udhëheqësi i studimit. Tema e diplomës vlerësohet me pikë individuale nga secili anëtar i komisionit dhe në fund llogaritet mesatarja aritmetike.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj UV [format diplome dhe suplementi]. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Infermier e përgjithshme. Proçedura që ndiqet për tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit. Studenti paraqet kërkesën në sekretari, kryhen pagesë në bankë dhe tërheq dokumenta e programit të studimit në departament brenda 10 ditëve pas dorëzimit të




	pagesës. Tarifa e pagesës është e përcaktuar me vendim të senatit akademik. [dosja e programit]			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretaritë mësimore të fakultetit gjendet regjistri themeltarë i studentëve, regjistri i vlerësimit të mara nga studentët gatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave. [regjistrat dhe procedura e verifikimit të informacionit për studentët].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të	Gjatë vizitës on line në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UV disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Bsc Infermieri e përgjithshme”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semester, dosjen personale për staf jo akademik si dhe regjistrin themeltarë të stafit. Në regjistrin themeltar të stafit hidhen të dhënat si : data e fillimit të punësimit, ndryshimet e vendit të punës nqs ka deri në largimin dhe tërheqjen

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>e librezës së punës nga individ. Çdo vit Zyra e burimeve njerzore bën dhe përditësimine CV të stafit dhe mbledhjene e dokumentacionit plotësues përkatës.</p> <p>Institucioni ka vene ne disponon listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit ne sistem GVJ konstaton se mungojnë CV të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin e zyrës së burimeve njerzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi me sondazh dosje të personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Dosja e stafit akademik përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentacionin qe ka dorezuar ne momentin e aplikimit. 2. Librezen e punes 3. CV 4. Liste notash, Diplome, Diplome gjuhe te huaj, deshmi penaliteti, raport mjeko ligjor 5. Fotokopje ID 6. Proceduren e punesimit 7. Vleresimin e fazes se konkursit <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UV (statusi UV) dhe kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteretë posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në statusin e UV dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kriteretë për rekrutimin e personelit. Parashikime për staf të ri bëhen për çdo vit akademik. nga departamenti.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe vjetore. Ngarkesa formalizohet në “marveshjen për organizimin e kohës së punës” midis petagogut dhe drejtuesit të departamentit.</p> <p>Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik të nevojshme për realizimin e programit të studimit. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjellë në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat</p>




	<p>vendet e lira te punes shpallen në faqen e ËEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithsme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit (shtojca 10 e rregullores së FSHP). Dorëzimi i dokumentacionit bëhet me rugë postare. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret për rekrutimin e stafit akademik përcaktohen nga departamenti përgjegjës në bazë të nevojave specifike dhe i përcillen zyrës së burimeve njerëzore. Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurimi kalon në dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim në bazë të dosjes 2. Intervista gojore <p>Kur një dosje skualifikohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5 ditë duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritet 5 ditë pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet dekanit. [evidenca 2.22. Procedura e punësimit të stafit akademik]</p> <p>FSHP ka një procedurë të përcaktuar dhe për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave klinike që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjes që kanë. Udhëheqësi i praktikës klinike duhet të zotëroj diplomë të ciklit të dytë [evidenca 1.30. Procedura e përcaktimit të udhëheqësve të praktikës klinike].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>✓</p>	




Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UV ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin me qëllim kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor. DI ka në dispozicion një hapësirë 40m ² për stafin akademik dhe drejtuesin e departamentit. Zyrat e stafit janë të paisura me tavolin pune, kompjutera personal, printera, fotokopje etj si dhe materiale kancelarie për kryerjen e procesit mësimor. Sekretaria ka ambiente të bollshme dhe bashkëkohore për pritjen e studentëve dhe kryerjen e detyrave të saj funksionale. Institucioni ka ambiente të dedikuara për arkivën. Në planet e ardhshme të UV është ndërtimi i godinës re për FSHP çka do të mundësojë krijimin e ambienteve të mjaftueshme në funksion të realizimit të misionit të tij në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetit. [Dokumneti kapacitete e godinave të UV. Projekti i ri i godinës së FSHP].
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimi me personelin akademik, personeli akademik shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre duke i përfshirë në projekte të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale. FSHP mbështet stafin e tij në realizimin e programeve të doktoraturës, apo kualifikime profesionale me anë të lehtësimit të ngarkesës mësimore apo mbështetje financiare për botime të punës së tyre, pjesmarje në aktivitete trajnuese si dhe i ka siguruar mundësi stafit të vet në kualifikime të ciklit të dytë. [takimi me personelin akademik]. GVJ evidenton në CV që personeli akademik i cili mbulon programin e studimit, ka një aktivitet shkencor të pasur si në botime shkencore ashtu dhe në prezantime në aktivitete të ndryshme të shkencave mjekësore.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni është përfshirë në një sërë projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm dhe me partnerë nga vendet e BE-së për rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale. Një vend të rëndësishëm zënë programet për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe shrytëzimin e risive të teknologjisë. Vend të rëndësishëm në trajnimin e stafit zënë projektet erasmus + dhe KAI, AKSSHI, seminarët trajnuese të organizuara me institucionet shëndetësore etj UV ka hartuar dhe një udhëzues

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	specifik mbi përdorimin e metodave të mësimdhënies i cili i është vënë në dispozicion stafit akademik dhe ndihmës akademik.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë ka siguruar angazhim optimal të burimeve njerëzore. Në realizimin e këtij program studimi janë përfshirë pedagogë me kohëtë plote të DI dhe departamenteve të tjera të FSHP, pedagogë me kontratë sidomos udhëheq së praktikave klinike nga institucionet ku realizohet praktika, pedagogë efektivë nga fakultete e tjera të UV për realizimin e lëndëve të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, IT etj si dhe staf mbështetës në funksion të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme. FSHP për realizimin e programeve të studimit zotëron një sip 3200m ² duke plotësuar standartin 5m ² /student sipas VKM 418, datë 10.05.2017. Në dispozicion të programeve të studimit janë dhe ambientet dhe salla e telemedicinës në spitalin e vlorës me 100 poste ku zhvillohen leksionet e Obsetrikes dhe kirurgjisë. Salla e leksioneve në spitalin psiqiatrik “Ali Mihali” me 100 poste ku realizohet moduli i shëndetit mendor. Spitali i Fierit salla e seminareve me 30 poste si dhe ambiente ku zhvillohen konsultat për raste klinike si dhe akomodimin e studentëve. Pjesa kryesore e lëndëve zhvillohet në pjesën D e cila zotëron : 5 salla leksionesh me 50-100 poste 1 klase seminare me 50 poste 2 laboratorë infermierie 15 poste

	<p>2 lab anatomie me 20 poste 1 lab mamie me 15 poste 1 qënder simulatore</p> <p>Ndërsa lëndët si gjuhë e huaj, biologji, kimi, TIK zhvillohen në godinat B dhe C në salla me 50-100 poste.</p> <p>Në buxhetin afat mesëm të UV është parashikuar ndërtimi i godinës së re të FSHP me sip 5000m² e cila do të shërbejë ritjes së cilësisë së mësimdhënies në një standart të lartë bashkëkohor.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raportin me numrin e posteve në sallë. Një pjesë e ambientet mësimore janë me sistem kondicionimi. Ambientet e FSHP kanë një hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës on line në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksionin të programit janë në dispozicion 8 videoprojektorë portable dhe një fotoprojektorë.</p> <p>Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. [vizita e ambienteve]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DI zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në DI apo deparatmantete të tjera të FSHP. Laboratorët e infermierisë, anatomisë dhe qëndra simulatore janë të pajisur me infrastrukturë bashkëkohore për realizimin e praktikave mësimore si TV dhe videoregjistrues, manikina pediatrike dhe adulte për kryerjen e procedurave infermirore, manikina simulatore në dispozicion të studentëve të gjithë programeve të studimit në infermieri dhe mami.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit në IP janë dhe 2 laboratorë të IT që gjenden në godinën C të UV. Këto laboratorë janë të pajisur me 45 kompjutera dhe programe profesionale për zhvillimin e laboratorëve të modulit të Teknologji Komunikimi dhe Informacioni.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	sipas programit të studimit FSHP dhe DI ku zhvillohet ky program studimi garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpaisura brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim marrëveshje bashkëpunimi që kanë nënshkruar me këto institucione [marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtare]. Nga sa më sipër, GVJ vlerëson kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UV ka në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik 3 Biblioteka me 3 salla leximi dhe 4 vetë personel, që ndodhen përkatësisht në godinën A(rektorati) që mbulon fakultetin e Ekonomisë me 2 specilistë të punësuar; godinën B që mbulon fakultetin e shkencave humane me (një) specialist që mbulon FSHP dhe biboteka e re në godinën C te Fakulteti i shkencave teknike me një specialist. Biblioteka është njësi ndihmëse e UV dhe është në varësi administrative të zv rektorit akademik dhe ndihmon në procesin mësimor në mësimdhënie/ mësimnxënie si dhe kërkimin shkencor. Orari i funksionimit të bibliotekës është i afishuar në ëëbin e UV. Biblioteka ka në total 120 vënde leximi të shpërndara 60 në bibliotekën A, 37 në bibliotekën B dhe 23 të C. Sipërfaqja e bibliotekës në godinën A është 250m ² dhe 90m ² në godinën B dhe 80m ² në godinën C. Në vitin akademik 2019-2020 në bibliotekën A në godinën e rektoratit është krijuar dhe arkiva e bibliotekës. Numri i frekuentuesve në total është 80. Biblioteka A 45, biblioteka B 25 dhe biblioteka C 15. Koeficienti i shfrytëzueshmërisë së bibliotekës 67%.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista	Fondi i bibliotekës përbëhet nga literaturë fizike tekste mësimore, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj., libra, revista në funksion të procesit mësimorë. Fondi i trashëguar i bibliotekës është 35000 tekste dhe 1500 tituj të siguruar nga blerje dhe dhuratat në gjuhën shqipe dhe të huaj(1994-2016). Për vitet 2016-2019 janë kryer dy blerje të cilat kanë ndikuar jo

<p>shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>vetëm në ritjen e tirazhit të librave por dhe përditësimin e literaturës në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor shkencor. Në këto blerje për FSHP janë siguruar 20 tituj shqip në 208 vëllime, në anglisht 50 tituj me 54 vëllime. Në bibliotekën qendrore shkencorë dhe godinën B për FSHP janë në dispozicion 105 tituj librash në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe tekste mësimore nga pedagogë të programeve të studimit [takimi me personelin e bibliotekës].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj dhe shqip, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. Katalogu bibliografik i koleksionit të bibliotekës përditësohet me tekset, revistat dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit ndërkombëtar Cobis Net nëpërmjet softit Cobib.al. Studentët kanë akses për shfrytëzimin e librarisë digjitale nëpërmjet linkut https://ulibrary.rash.al</p> <p>Universiteti po punon me akademinë e shkencave dhe rjetin e bibliotekave universitare për digitalizimin e standartizuar dhe unifikuar të librit, teksteve mësimore, revistave, artikujve shkencor dhe krijimin e bibliotekës kombëtare të digitalizuar.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik 17 kompjutera të shpërndara 9 në bibliotekën A dhe 4 në bibliotekën B dhe C.</p> <p>Biblioteka ka dhe dy projektorë në godinën A dhe C.</p> <p>Biblioteka ka akses interneti duke siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UV planifikon do vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me titujtë rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekste vijnë nga departamente e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkues me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Për vitin 2016-17 buxheti i vënë në dispozicion për pasurimin e fondit të bibliotekës është me libra është në vlerën 100 mijë lekë. Për vitin 2018-2019 buxheti i vënë në dispozicion për pasurimin e fondit të bibliotekës është me libra është në vlerën 60 mijë lekë dhe vitin 2019-2020 buxheti i vënë në dispozicion është 80 mijë lekë. [takimi me stafin e bibliotekës dhe evidence informacion I</p>




	bibliotekës shkencore]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sallat e 3(tre) bibliotekave janë të hapura gjatë orarit zyrtar të mësimit dhe janë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të fakultetit ekonomik dhe rektoratit. Orari i shfrytësimit të bibliotekës është i afishuar në ëëbin e UV. Biblioteka qendrore me orar 8 ⁰⁰ -20 ⁰⁰ në godinën A është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të fakultetit ekonomik dhe rektoratit, ndërsa mbase mund të shfrytëzohet nga studentët e të katër fakulteteve të UV. Në 2(dy) bibliotekat e tjera gjatë ditëve të javës, në fundjavë dhe ditëve të festave orari bibliotekës është 8. ⁰⁰ -16 ⁰⁰ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UV disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin UMS. Sekretaria mesimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Sekretaria mësimor ka në formë shkresore: <ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri themelatrë të studentëve • Rregjistri me të dhënat akademike • Rregjistri i lëshimit të diplomave Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.

	<p>Sekretaria mësimore arkivon :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjith dokumentacionin përkatës • Proçes verbalet e testime në provime . • Dosjet e diplommit; • dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës • listën e të diplomuarvë përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit dhe zyra e studentit. Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuar në manualin e përdorimit të sistemit UMS nga secili prej përfitueve të tij të publikuar nga zyra e IT [manualin e përdorimit të sistemit UMS nga studentët dhe pedagogë, informacion I zyrës e It, takimi me stafin e sekretarisë].</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm UMS shërben edhe për administrimin e informacionit në lidhje me aktivitetin akademik të stafit dhe personelit administrativ. Menxhimi i informacionit dhe dokumentacionit të pedagogëve realizohet nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe komunikimit”</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për student dhe pedagogët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë mer informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e UV bazuar në Ligjin “Për mbrotjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”[sistemi elektronic i menaxhimit të të dhënave, rregullorja e miratuar nga senati akademik për mbrotjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale].</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platformën e-learning të mesimdhënies on line e cila ofron informacion mësimor të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit</p>




<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>dhe informacionit mes pedagogut dhe studentëve si dhe kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimnxënies. Llogaritë e studentëve kanë dhe këndin e njoftime ku ata marrin njoftime nga administrata dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Institucioni përdor si metodë alternative për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit midis studentëve pedagogeve dhe sekretarisë dhe faqen e facebook te FSHP [ëeb UV, FSHP, Facebook FSHP]</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma e-learning funksionon si një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarëve, për të monitoruar në kohë reale mbarëvajtjen e procesit të akademik dhe administrativ. Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore, zyra e studentit dhe menaxhimit të FSHP (dekan i fakultetit). Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik simestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. Dekani bën adresimin elektronik të problematikave të konstatuara në : rubrikën shërbime. [Ëëbi i FSHP, sistemi UMS i dekanit të FSHP].</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja Zyrtare e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë është : ëëë.univlora.edu.al. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organigramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UV, programet mësimorë që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UV dhe fakultete, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionin UV, fakultet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj.</p> <p>Faqja zyrtare në ëeb aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe dhe po punohet të përgatitet dhe në gjuhën angleze[takimi me stafin drejtues].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>




Standardi IV.6
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik FSHP harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo program bazuar në VKM 638 datë 22.07.2015. Tarifat e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. [Evidenca 4.18]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga auditimi i MARS dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditimi vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. Në vitin 2019 është ngritur dhe njësisia e auditit të brendshëm. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare (grante, projekte) për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik. [evidence . Publikimi i shpenzimeve buxhetore, tabela 18 ASCAL]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo</p>	<p>Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet. [vendimi BA për miratim buxhett, shkresa e drejtorit të burimeve mbështetëse]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MARS të ardhurat nga shërbimet që kryhen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin	Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë dhe Fakulteti i Shëndetit Publik kanë hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</p> <p>Në rregulloret e FSHP dhe rregulloret e departamenteve të kujdesit shëndetësor (DKSH) dhe të infermierisë (DI) përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta.</p> <p>Në rregullore, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Pranë departamenteve të FSHP funksionon zyra e këshillimit të studentëve. Këshilltari akademik është pika e referimit të studentëve gjatë viteve të studimit.</p> <p>Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit.</p> <p>[Statuti i UV, rregulloret e FSHP, DKSH dhe DI]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHP ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.</p> <p>Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p> <p>[statuti i UV, Rregulloret dhe evidencat e programeve të mobilitetit Erasmus, takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në kreun 3 të rregullores së departamentit janë shkruar qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Organizimin e programeve të studimit – Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë – Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave – Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi – Rregullat e ekuivalentimit etj. <p>Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve,</p>




	<p>realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.</p> <p>Pranë departamentit funksionon zyra e këshilltarit akademik. Këshilltari akademik emërohet cdo fillim viti dhe krijon Grupin e tutoratit të studentëve me student të viteve të fundit të studimit. Këshilltari akademik dhe grupi i tutoriatit kontaktojnë dhe asistojnë studenë e rinj që në regjistrim.</p> <p>Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen ëeb të Universitetit të Vlorës.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshilltarit akademik, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre.</p> <p>[Rregulloret e departamentit dhe programit të studimit, faqja ëeb e UV, takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar në rregulloret e departamentit dhe të programit të studimit kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për cdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me VKM. Për studentët me të njëjtën mesatare dhe të njëjtin numër pikësh, rregullorja e programit të studimit përcakton si kriter të veçantë përzgjedhës, mesataren e lëndëve Kimi-Biologji.</p> <p>Në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues ka evidence të procedurës ligjore të ndjekur cdo vit për hartimin dhe publikimin e kriterëve për pranimin në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>[RVB, Rregulloret e departamentit dhe programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të</p>	<p>Hartimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin në programet e ciklit të parë të studimit mbështetet në aktet ligjore të MASR. Në nenin 30 të rregullores së departamentit përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara.</p> <p>Pas kërkesës së MASR, cdo vit departamenti përcakton kriteret dhe kuotat e pranimit të cilat aprovohen nga Senati akademik.</p>




huaj.	Senati akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MASR. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit (ualbania.al). [evidencat 5.2 – 5.4, rregullore e programit të studimit]			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UV dhe FSHP kanë në traditën e tyre organizimin e ditëve të hapura informuese në të cilat, prindër dhe gjimnazistë të interesuar për programet e studimit informohen nga pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete organizohen zakonisht në periudhën mars – maj dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen ëeb të UV. [Evidencat 5.6, 5.7 dhe takimi në universitet]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit: <ul style="list-style-type: none"> – Leksione 75% – Seminare/Laboratorë/Praktika 100%: nëse student ka 25% mungesa të arsyetuara ato mund të shlyen para sezonit të provimeve. Të dhënat për frekuentimin janë të pasqyruara dhe në syllabusin e secilës lëndë. Për studentët që vlerësohen me notën 4, jepet mundësia e

	<p>riprovimit për jo më shumë se 40 ECTS.</p> <p><i>GVJ konstaton se ka një mospërputhje të shkrimit për masën e frekuentimit për leksionet dhe seminarët në rregulloren e departamentit -syllabuset me rregulloren e programit të studimit. Po ashtu GVJ nuk gjeti informacion në rregulloren e departamentit dhe programit mbi numrin e ECTS të detyrueshme për kalimin nga një vit në tjetrin apo për procedurën e përcaktimit të tyre. GVJ rekomandon korrigjimin eventual të shifrave në rregulloren e programit të studimit.</i></p> <p>[rregulloret e departamentit dhe programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në të dy rregulloret ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. [rregulloret e departamentit dhe programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllqbus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi i vazhduar ka dy komponentë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Provim me shkrim (kolokium) që përfshin rreth 30 % të programit të lëndës dhe zë 30% të notës përfundimtare – Vlerësimin e vazhduar gjatë semestrit (detyra kursi) që zë 10% të notës përfundimtare. <p>Provimi përfundimtar zë 60% të notës përfundimtare.</p> <p>Në syllabuse përcaktohet në mënyrë të detajuar pragu i pikëve kaluese dhe konvertimi i pikëve në nota.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p>[rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka</p>

<p>punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>pregatitur dhe një manual (evidenca 3.86) instruktues për përgatitjen e temës së diplomës. Në rregullore përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome <ol style="list-style-type: none"> 1. Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimimit dhe rivlerësimit. 2. Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës. - Kushtet që duhet të përmbushë student për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj) për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb të UV</p> <p>[evidencat 5.6, 5.7, 5.9 dhe faqja ëeb]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët që ndjekin programet mësimore Bcs në Infermieri e Përgjithshme informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Në dosjen e programit të studimit ata gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<ul style="list-style-type: none"> - Informacion për objektivat formuese të programit - Strukturën dhe organizimin e programit - Planin mësimor - Syllabuset - Rregulloren - Suplementin e diplomës
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studentit gjëhen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studentit orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të irës së mësimi (leksion, seminar, praktikë).</p> <p>Studentët e vitit të parë informohen dhe orientohen që në fillim nga Këshilltari akademik dhe grupi i tutoriatit që ai krijon me studentët të viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësore dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Institucioni merr informacion dhe nga portali Infermierë për Shqipërinë. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe gjithë informacionin që merr nga agjensi të huaja punësimi, megjithëse i mungojnë statistikat e sakta. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës.</p> <p>[evidencat 5.10 – 5.12, takimi me GVB]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në dosjen e programit të studimit studentit informohet dhe me infrastrukturën e programit të studimit. Pika e fortë e infrastrukturës së programit janë laboratorët që përdorin teknologji të avancuar për aftësimin praktik të studentëve. Numri i klasave është optimal dhe nga vizita në universitet konstatohet që janë OK. GVJ vlerëson me shumë pozitivitet ambicien e FSHP për të patur një godinë të re të dedikuar për</p>




	<p>mësimdhëniene në këtë deprimant.</p> <p>Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitalet rajonale.</p> <p>Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë.</p> <p>[dosja e programit të studimit, vizita në universitet, marrëveshjet e bashkëpunimit]</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Në RVB theksohet se UV ka një system informatic të brendshëm përmes të cilit mundësohet informimi studentit pëe programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në cdo moment. Vec detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. platforma sivjet i ka shërbyer mesimit on line.</p> <p>[evidenca e llogarisë së studentit, faqja ëeb e programit të studimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi V.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në sekretarinë mësimore të FSHP janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi. Sekretaria ka</p> <ul style="list-style-type: none"> – Regjistrin themeltar të studentëve – Regjistrin e lëshimit të diplomave – Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave) <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p>

	[evidencat 3.91 – 3.93]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të cregjistrimit. (evidencat 1.32, 1.33, 4.10, 5.14, 5.15) Në takimin me sekretarinë mësimore u kërkua praktika e stabilizuar për regjistrimin e studentëve pa numër matrikullimi. Në përgjigje të interesimit të GVJ institucioni vuri në dispozicionin tonë dokumentacion shtesë, praktikat e komunikimit për zgjidhjen e këtij problemi.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	GVJ konstaton se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi deri në diplomim. Në sekretarinë mësimore të dhënat arkivohen në regjistrin e notave si dhe në formë procesverbalesh. Në departament ruhen regjistrat e lëndëve si dhe procesverbalet e lëndëve. Me kërkesën e GVJ, institucioni ka dërguar dokumentacion shtesë modelet e regjistrave të lëndëve dhe regjistrave të praktikës.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen të përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, UV ka përpiluar rregulloren për regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumentave në UV. Kjo rregullore [evidenca 5.16] është miratuar me vendim të senatit akademik. Dokumentacioni ruhet në kasafortën e sekretarisë mësimore; prej tij përpilohen dokumentat që iu dorëzohen studentëve. GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre,	Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i Infermierit. Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesit e FSHP, GVJ kërkoi informacion mbi licensimin dhe

duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	punësimin e studentëve të programeve të studimit të FSHP. GVJ u informua se kalueshmëria në provimin e licensimit është 82% në nivel fakulteti. Ka kërkesa të mëdha për punësim edhe jashtë Shqipërisë. Me krijimin e zyrës së Alumni është parashikuar skedim i plotë i informacionit për punësimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UA. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UV, në Bordin e administrimit, në Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Studentët organizojnë Këshillin studentor. Studentët kanë qenë pjesmarrës dhe në hartimin e RVB. [statuti i UV, rregulloret e FSHP]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Kriteri 2. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (kriteri 1) por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetsorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHP. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. [evidencat e trajtimit të ankesave dhe procedura e vlerësimit dhe trajtimit të rekomandimeve të pyetsorëve, takimi me studentët]

<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit parashikohen qartë procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të elementëve të studimit.</p> <p>Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies edhe në kushtet aktuale të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve online. Studentët gjykojnë se praktikatat në laboratorët simulatorë dhe praktikatat profesionale në spitalet rajonale i përgatisin mjaft mirë për tregun e punës. Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Natyrisht, studentët shprehën shqetësimin e pamundësisë për të kryer praktikë me pacientë në situatën aktuale, si pasojë e rregulave anti COVID.</p> <p>[plani mësimor, rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimin të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHP për zgjidhje. Këshilltari akademik është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.</p> <p>Pyetsorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Në dokumentacionin shtesë na u vu në dispozicion dhe procedura e rishikimit të pyetsorit të studentëve.</p> <p>Në dokumentacion por dhe në takimin me studentët u evidentua përfshirja e tyre në përmirësimin e raportit teori-praktikë në lëndën e infermieristikës.</p> <p>[takimi në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit,</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehën të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve (provime me shkrim) dhe me mundësitë që ata kanë për ankimit rezultati dhe</p>




rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>FSHP ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zyra e këshillimit akademik që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Këshilltari akademik asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit. Grupi i tutoratit krijohet nga student të viteve të larta dhe asiston studentët e vitit të parë në adaptimin me sistemin e mësimdhënies dhe akomodimin në UV. – Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. – Zyra e studentit: informon studentët për sistemin e bursave, sistemin e akomodimit (konviktet) – Koordinator i praktikave: koordinon studentët për praktikat në spitalet rajonale. – Faqe e facebook e FSHP <p>[rregulloret e FSHP, departamenteve, takimi në institucion]</p>




<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët.</p> <p>[takimi në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në institucion funksionon zyra e këshillimit të karrierës, Alumni. Kjo zyrë është riorganizuar për të ofruar shërbim më të mirë në kuadër të strukturimit të programeve dhe ofrimit të programeve të reja. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë – Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës – Identifikimin e aftësive dhe shprehive <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p>Zyra ofron një seri aktivitetimesh për orientimin e studentëve në tregun e punës si Open Day, Ditët e informimit, Panairin “Ëork and Study”. Në bashkëpunim me strukturat e tjera akademike, zyra e këshillimit të karrierës ka organizuar Konferencën e parë studentore të FSHP ku studentët u paraqitën me punimet e tyre.</p> <p>NË fillim të vitit zyra parashikon aktivitetet dhe përcakton buxhetin për to; buxheti i dërgohet për miratim Këshillit të Administrimit).</p> <p>[evidencat 5.6 – 5.12, programi i konferencës, takimi në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë</p>	<p>Në takimin e GVJ me zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se kjo njësi është riorganizuar së fundmi dhe ka në database informacion për studentët e diplomuar në dy vitet e fundit. Njësia e këshillimit të karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit. Ajo disponon listë me punësimet e studentëve. Sipas informacionit që njësia disponon, rreth 90% e studentëve janë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	punësuar. Situata e pandemisë ka vonuar krijimin e database të plotë si dhe ka bllokuar iniciativën e kësaj njësie për organizimin e Shoqatës Alumni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UV dhe në rregulloren e institucionit.</p> <p>Në RVB evidentohet se politikat e sigurimit të cilësisë detajohen dhe në planet strategjike të institucionit. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. Në RVB gjejmë evidenca të vendimeve të senatit për aprovimin e pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>të shërbimeve administrative, vendimeve për aprovimin e formateve të vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Me vendim senati, në vitin 2016, UV ka ngritur Njësinë e Vlerësimit dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) për institucionin.</p> <p>[evidencat A, B, C, 3.3 – 3.9, 6.1 – 6.3]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC e krijuar në vitin 2016 është riorganizuar në vitin 2018 si sektor në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve përbëhet nga 4 personel ndihmës akademik. Kuadri ligjor ku mbështet veprimtarinë NJSBC është:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015 – Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018) – Manuali për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL – Statuti i institucionit – Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës <p><i>NJSBC po punon për hartimin e rregullores së funksionimit të saj.</i></p> <p><i>Situata e pandemisë ka vonuar procedurat e miratimit të tij. NJSBC nuk ka në përbërje studentë apo bashkëpunëtorë të jashtëm. GVJ rekomandon përfshirjen e përfaqësuesit të studentëve dhe një eksperti të jashtëm në NJSBC.</i></p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve tremujore dhe vjetore. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional. – Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në jësitë bazë. – Administron dokumentacione, organizon dhe pregatit vizita të vlerësimit të jashtëm. <p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare</p>




	<p>dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p> <p>NJSBC në vijim të një projekti me partnerë të huaj po aplikon metodologjinë e analizës me studentin në qendër. Kjo metodologji ka rezultuar e suksesshme dhe pikë e fortë e UV.</p> <p>[statuti i UV, rregulloret, evidencat 6.2 – 6.6, takimi në institucion]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UV ka përmbushur detyrimin ligjor të akreditimit institucional për një periudhë 3 vjeçar në vitin 2017 dhe po punon për akreditimin e programeve të studimit. Për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit, UV ka përpiluar një plan veprimi të miratuar në Senatin Akademik. Në takimin me përfaqësues të NJSBC GVJ u informua se njësia monitoron plotësimin e rekomandimeve dhe organizon aktivitete për përmbushjen e tyre. NJSBC bën vlerësime krahasuese të parametrave të programit midis viteve, krahasime të mesatares së lëndëve me mesataren në nivel programi etj.</p> <p>[takimi në institucion, RVB]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në dokumentat e statutit dhe rregulloreve të institucionit përcaktohet terminologjia bazë e sigurimit dhe përmirësimit të brendshëm të cilësisë. <i>GVJ inkurajon përpilimin e rregullores së NJSBC.</i> Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit shoqërues dhe në takimet me përfaqësues të NJSBC dhe studentët, GVJ konstaton se institucioni aplikon procedura periodike (pyetorë dhe analiza 3 mujore dhe vjetore) në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. Referuar mbështetjes buxhetore, NJSBC referon se përmbush 90% të aktiviteteve të planifikuara në funksion të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Aplikimi i procedurave të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë dhe promovimi përmes aktiviteteve të NJSBC, analiza dhe krahasimi i rezultateve me treguesit e cilësisë, synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional përfshi njësitë përbërëse dhe gjithë aktorët e brendshëm të institucionit.</p> <p>[statute, rregulloret, takimi në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	




Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në Universitetin e Vlorës funksionon Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, njësi e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit. Në nivel institucioni funksionon dhe NJSBC e cila përmes përmbushjes së misionit të saj jep kontribut në monitorimin, shqyrtimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në takimin me personel të Drejtorisë së Edukimit, GVJ u njoh me aspekte praktike të zyrës së kurikulave pranë kësaj drejtorie.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Riorganizimi i programeve të nivelit Master Profesional në degët e Infermierisë (kalimi nga 90 në 60 ECTS sipas kërkesave ligjore) – Aplikimi për hapjen e programeve të reja dy vjecare – Përcaktimi dhe monitorimi i ngarkesës mësimore të pedagogëve. – Unifikimi i standartit për literaturën <p>Në RVB ka evidenca të analizave periodike të departamenteve të FSHP dhe propozimeve respektive për rishikim të programeve të studimit.</p> <p>[takimi në institucion, RVB, evidencat 3.9, 6.8, 5.27]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>FSHP përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të</p>	<p>Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike. Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Analiza vjetore e departamentit

studimeve.	<ul style="list-style-type: none"> – Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik – Pyetsori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien – Pyetsori i studentëve për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga stafi ndihmës akademik dhe administrative. <p>[RVB, evidencat 1.6, 3.4, 3.5, 6.1, 6.10; L]</p>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Universiteti i Vlorës ka përcaktuar me vendim senati (vendim nr.21 dt. 8.5.2018) procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetsorëve. Dokumentimi analitik i rezultateve realizohet nga NJSBC. NJSBC përpilon gjithashtu projektpropozimet dhe rekomandimet mbështetur në analizën e pyetsorëve dhe formularëve të performancës. Raporti i dërgohet njësisë kryesore e cila ia përcjell departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit. [evidencat 3.9, 5.27, takimi në institucion]</p>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSHP. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Planin e masave është i detyrueshëm për të gjithë personelin akademik që angazhohet në programin e studimit.</p> <p>[evidencat e analizave vjetore të departamentit dhe evidencat e planit të masave të departamenteve dhe UV]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi.	NJSBC, mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga analiza e pyetsorëve harton raporte në mënyrë periodike që vihen në dispozicion të njësisë bazë. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Përmes tyre vlerësohen pikat e dobëta, pikat e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>forta dhe praktikat më të mira për cdo program studimi.</p> <p>Institucioni kryhen një analizë gjithëpërfshirëse vjetore dhe paraqet Raportin vjetor të Universitetit. Ky raport dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR.</p> <p>Informacionet e vetëvlerësimit janë përfshirë në raportin e grupit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit institucional dhe në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Në takimin në institucion, GVJ konstatoi një bashkëpunim dhe koordinim të mirë të GVB me NJSBC për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.</p> <p>[RVB, raportet vjetore dhe analizat vjetore të UV, DI, DKSH]</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programeve akademike në fushën specifike të infermierisë është bërë duke përdorur metodën sasiore si metodë e gjykuar më e përshtatshme. Instrumenti vlerësues i përdorur është pyetsori. Pyetsori plotësohet në anonimitet duke respektuar rregullat e etikës. Pyetsori përmban pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura.</p> <p>[evidencat e pyetsorëve dhe vendimeve për aprovimin e tyre]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamentet e FSHP analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Numri i studentëve frekuentues – Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikve – Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore – Plotësimi i standarteve të stafit akademik – Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve – Kalueshmëria dhe cilësia semestrare – Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale – Numri i të diplomuarve – Kalueshmëria në provimin e shtetit – Raportet leksion /laborator – Konkluzionet e pyetsorit të studentëve – Ankesat e protokolluara të studentëve

	[evidencat 1.6, 6.10]			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim ze informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni. Që prej dy vjetësh, kjo zyrë përpunon informacionin e plotë mbi punësimin e studentëve pas diplomimit, brenda apo jashtë vendit. Po ashtu, përmes kësaj zyre po realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Punësimi i studentëve pas diplomimit është një tregues i rëndësishëm indirekt i cilësisë së programit të studimit. Sipas të dhënave të referuara, rreth 90% e studentëve punësohen menjëherë pas përfundimit të programeve të studimit Bcs në Infermieri dhe në Infermieri Mami. Në takimin me sekretarinë mësimore GVJ u informua se në periudhën 2 vjecare numërohen rreth 90 studentë që kanë kërkuar dokumentacionin për efekt të aplikimit për punë jashtë Shqipërisë. Në takimet me stafet dhe drejtuesit e FSHP na u referua se 4 studentë që kanë përfunduar studimet në FSHP punojnë si personel akademik në Universitetin e Prishtinës.</p> <p>Institucioni bashkëpunon dhe merr informacion për programin e studimit dhe nga drejtuesit dhe mbikqyrësit e praktikave profesionale. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës.</p> <p>Për përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen me tregun e punës institucioni është përfshirë në disa projekte internacionale.</p> <p style="text-align: center;">[evidencat 2.17 – 2.20, 5.24 – 5.25, takimi në institucion, RVB]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓




Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2018 – 2024 të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë parashikohen përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar në procedurat e brendshme të sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë.</p> <p><i>Megjithëse në përbërje të NJSBC nuk ka student apo përfaqësues të jashtëm</i>, kjo njësi në punën e saj bashkëvepron me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. <i>GVJ inkurajon përfshirjen e përfaqësuesit të studentëve në NJSBC.</i></p> <p>[evidencat A, B, C, 3.1, 3.9]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHP, Përgjegjësit e Departamenteve të Infermierisë dhe Kujdesit Shëndetësor, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë.</p> <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëpunuar konform rregullave, në harmoni të plotë.</p> <p>Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve</p>



	të tyre në GVB.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore. Në mungesë të një zyre të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti, ky funksion është realizuar nga dekanati i cili bashkëpunon dhe shkëmben informacion me NJSBC për problemet e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>GVJ inkurajon përfundimin e shkrimit dhe aprovimit të rregullores së NJSBC dhe krijimin e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë pranë FSHP për realizimin e një bashkëpunimi hierarkik dhe harmonik në funksion të sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p>[statuti i UV dhe rregulloret]</p>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi.</p> <p>[evidenca 3.9 dhe kodi i etikës]</p>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>NJSBC përcakton indikatorët për vlerësimin e programit të studimit dhe përpilon raportin përmbledhës të pyetsorëve të studentëve. Për një vlerësim më objektiv të programit të studimit dhe gjetjen e instrumentave më të mirë për përmirësim dhe përshtatje me tregun e punës, NJSBC organizon takime në nivel institucional e deri në nivel programi me pale të interesuara si punëdhënës të tregut publik apo privat dhe studentë alumni.</p> <p>RVB dhe dokumentacioni shoqërues evidenton disa nga aktivitetet me përfshirjen e palëve të interesuara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. [faqja ëeb, shkresat e NJSBC]
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC harton një herë në vit raportin e analizës së pyetsorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për cdo lëndë të cdo programi studimi. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti publikohet në nivel të njësisë kryesore dhe gjetjet e rekomandimet i transmetohen departamentit. [evidencat 3.9, 6.12, takimi në institucion]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në vendimin e senatit 21 dt 8.5.2018, kodifikohet procedura e analizës dhe vlerësimit të pyetsorëve. Kjo procedurë parashikon shkrimin e propozimeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë mbeshtetur në gjetjet e analizës. Referuar ketyre propozimeve institucioni përpilon planin e masave i cili kthen në akte të detyrueshme për zbatim rekomandimet. Plani i masave miratohet nga senati akademik dhe publikohet në faqen zyrtare të UV. Zbatimi i planit monitorohet nga Zv. Rektori, Dekanët dhe NJSBC. Edhe në nivel fakulteti hartohet plan masash për zbatimin e rekomandimeve. Ky plan është i detyrueshëm për të gjithë personelin akademik të përfshirë në realizimin e programit të studimit.



	[evidencat e planeve të masave të UV dhe departamenteve]			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, NJSBC punon për përmirësimin e instrumentave të përdorur për vlerësim si dhe gjetjen e instrumentave të tjerë vlerësues.</p> <p>Në takimin me NJSBC si dhe në RVB u evidentuan përpjekjet për përmirësimin e pyetsorëve të studentëve (urdhër i rektorit 123 dt. 19.12.2019). Kështu në pyetsorin e vitit 2020 – 2021 janë përfshirë dhe pyetje për bibliotekën fizike, bibliotekën on line dhe shkallën e shfrytëzimit të literaturës. Po bëhen përpjekje për të realizuar dhe pyetsorë me personelin për vlerësimin e menaxhimit të institucionit.</p> <p>[evidenca 3.9, 6.4 dhe takimi në institucion]</p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Studenti është në qendër të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. NJSBC informon studentët në takime individuale apo të organizuara për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e programit të studimit. Në takimin me grupin e studentëve GVJ mori përshtypje pozitive për përfshirjen e tyre aktive në vlerësimin përmes pyetsorëv si dhe për përfshirjen me propozime konkrete në përmirësimin e syllabuseve (shtimi i orëve të praktikës në lëndën e infermieristikës)</p> <p>[evidencat 5.22, 6.14, takimi me studentët]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Infermieri e Përgjithshme” i Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Infermieri e Përgjithshme" është hartuar bazuar në modelet më të mira kombëtare dhe evropiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Personeli përgjithësisht është i kualifikuar dhe me përvojë për zbatimin e programit
3. Infrastruktura laboratorike bashkëkohore dhe me paisjet e nevojshme në funksion të programeve të studimit
4. Zhvillimi i module të caktuar në infermieri në gjuhë të huaj në ndihmë të mobililitetit të studenteve dhe përshtatjes së tyre me tregun e punës.
5. Përqindja e lartë e orëve praktike krijon mundësi për aftësimin profesional praktik të studenteve si dhe përfitimin e shprehive dhe aftësive të duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre.
6. Bibloteka me njëliteraturë të pasur dhe përditësuar, e organizuar dhe skeduar në mënyre profesionale, me infrastrukture të nevojshme në funksion të studenteve dhe stafit akademik

Pika të dobta:

1. Numri jo imjaftueshëm i petagogeve të kategorisë profesor.
2. Mungesa e ambienteve të veçanta dhe të dedikuara Fakultetit të Shëndetit.

Rekomandime:

Grupi i vlerësuesve të jashtëm i rekomandon Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë

1. Të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës sipas formimit profesional dhe gradës së kualifikimit të personelit akademik si dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme.
2. Rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe emërimin titullar lënde të pedagogëve të kategorisë profesor
3. Hartimin e një projekti për ndërtimin e një godine të veçantë për Fakultetin e Shëndetit me infrastrukturë moderne dhe të përshtatshme për shkencat mjekësore.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor "General Nurse" of Higher Education Institution University "Ismail Qemali" Vlorë

Strength points:

1. Curriculum of the study program of the first cycle Bachelor "General Nurse" is designed based on the best national and European models, respecting the standards and legal framework in power.
2. Staff is generally qualified and experienced for the implementation of the program.
3. Contemporary laboratory infrastructure with the necessary equipment in function of the study programs
4. Development of certain modules / in general nurse in foreign languages to help students' mobility and their adaptation to the labor market
5. The high percentage of practical hours creates opportunities for practical professional training of students as well as the gaining of appropriate skills and competencies needed in the practice of their profession.
6. Library with a rich and updated literature, organized and filed in a professional way, with the necessary infrastructure for the function of students and academic staff

Weak points:

1. Insufficient number of academic staff from the category of professor.
2. Lack of facilities dedicated to the faculty of health.

Recommendations:

The external evaluation team recommends the University "Ismail Qemali" Vlorë

1. To review the distribution of the workload according to the professional training and the degree of qualification of the academic staff as well as the grouping according to similar typologies.



2. Review of course holders and pointment “course holders” the academic staff of the professor category
3. Development the project of new building for “Faculty of Health” as part of Vlora University with modern and appropriate infrastructure for medical sciences.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				✓


